



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.99**

**27 korrik**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                |      |
|-----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.514, datë 6.7.2011    | Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë pyjore lugina e Fanit të Vogël, Mirditë, që do të përdoren nga shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., për ushtrim veprimtarie minerare.....                                            | 3991 |
| Urdhër i METE<br>nr.312, datë 13.4.2011 | Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve minerare.....                                                                                                                    | 3993 |
| Urdhër i METE<br>nr.382, datë 20.5.2011 | Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare.....                                                                                       | 3994 |
| Urdhër i METE<br>nr.383, datë 20.5.2011 | Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të veprimtarive për mbylljen e një veprimtarie minerare.....                                                                                                                                  | 3997 |
| Urdhër i METE<br>nr.384, datë 20.5.2011 | Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrin minerar, si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare..... | 4003 |
| Urdhër i METE<br>nr.386, datë 20.5.2011 | Për miratimin e rregullave për përdorimin e të dhënave minerare të një lejeve minerare.....                                                                                                                                                    | 4007 |
| Urdhër i METE<br>nr.387, datë 20.5.2011 | Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së projektit të konservimit të minierës.....                                                                                                                                                            | 4008 |
| Urdhër i METE<br>nr.388, datë 20.5.2011 | Për miratimin e formës dhe përmbajtjes të planit të monitorimit postminerar.....                                                                                                                                                               | 4011 |
| Urdhër i METE<br>nr.414, datë 3.6.2011  | Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të menaxhimit dhe informacioneve që mbahen nga zotëruesi i lejes minerare për punimet e kryera, depozitimin, trajtimin e mbetjeve minerare dhe analizimin e tyre.....                         | 4017 |

**VENDIM**  
**Nr.514, datë 6.7.2011**

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE**  
**LUGINA E FANIT TË VOGËL, MIRDITË, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA “PRENDI-02”**  
**SHPK, PËR USHTRIM VEPRIMTARIE MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Sipërfaqet në ngastrat 54/a, 55/a dhe 56/a të ekonomisë pyjore lugina e Fanit të Vogël, Mirditë, gjithsej 9.568 (nëntë pikë pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ha, që do të përdoret nga shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., për shfrytëzimin me karrierë të objektit të bazaltëve, të hiqen nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi me karrierë të bazaltëve”, sipas kushteve të projektit të parashtruar dhe planimetrisë bashkëlidhur, në përputhje me vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

3. Sipërfaqja e mësipërme të regjistrohet në kadastrën minerare, në administrim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pronësi publike.

4. Shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., të paguajë, për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor si pasojë e ushtrimit të veprimtarive të parashikuara, tarifat e llogaritura sipas lidhjes nr.4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., të pyllëzojë me fondet e veta, brenda 2 (dy) viteve, 10 (dhjetë) ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor. Lloji i drurëve që do të mbillen dhe grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhë me kërkuesin.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar në pyll të hiqet nga kadastra minerare dhe të reregjistrohet fond pyjor.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

TABELA 1  
SIPËRFAQET QË HIQEN NGA FONDI PYJOR SIPAS PËRDORIMIT TË TERRITORIT DHE PRONËSISË

| Nr. | Emërtimi i ekonomisë       | Ngastra | Sip.që hiqet, ha | Përdorimi i territorit | Forma e qeverisjes | Funksioni Kryesor | Tipi i grumbullit | Pronësia   |
|-----|----------------------------|---------|------------------|------------------------|--------------------|-------------------|-------------------|------------|
| 1   | EP lugina e Fanit të Vogël | 54/a    | 5.000            | Pyll                   | Shkurre            | Prodhuës          | Shkurre           | Shtetërore |
| 2   | EP lugina e Fanit të Vogël | 55/a    | 3.500            | Pyll                   | Shkurre            | Prodhuës          | Shkurre           | Shtetërore |
| 3   | EP lugina e Fanit të Vogël | 56/a    | 1.068            | Pyll                   | Shkurre            | Prodhuës          | Shkurre           | Shtetërore |
|     | <b>TOTALI</b>              |         | <b>9.568</b>     |                        |                    |                   |                   |            |

## HARTA E SIPËRFAQES QË HIQET NGA FONDI PYJOR



Koordinatat e zones se kerkuar per shfrytezim:

- 1- X= 46 36 384 Y= 44 16 728
- 2- X= 46 36 278 Y= 44 16 651
- 3- X= 46 36 186 Y= 44 16 491
- 4- X= 46 36 223 Y= 44 16 168
- 5- X= 46 36 343 Y= 44 16 190
- 6- X= 46 36 417 Y= 44 16 565
- 7- X= 46 36 555 Y= 44 16 696

**Siperfaqja 0.09658 km<sup>2</sup>**

**URDHËR**  
**Nr.312, datë 13.4.2011**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË INFORMACIONEVE TË DETYRUESHME  
QË PËRGATITEN NGA ZOTËRUESIT E LEJEVE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 36 pika 23 dhe nenit 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”

**URDHËROJ:**

1. Çdo zotërues i një lejeje minerare kërkim-zbulimi duhet të përgatitë dhe të dorëzojë në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) informacionet e detyrueshme, sipas formatit, përcaktimeve të përmbajtjes dhe afatet e parashikuara në ligjin mineral nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Këto informacione të detyrueshme janë:

a) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e programit minimal të punës, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes;

b) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet në çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes, për çdo vit në vazhdim;

c) Informacionet 3 (tremujore) mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe të gjitha operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor;

d) Informacionin vjetor për veprimtarinë financiare dhe teknike të realizuar dhe të të gjitha operacioneve të kryera në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës, duke përfshirë të gjitha masat e marra për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës;

e) Vlerësimin vjetor për vlerat e garancisë për zbatimin e programit minimal të punës dhe të garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare, që paraqitet në çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit në vazhdim për miratim;

f) Raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimtarisë minerare duke dhënë në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë kërkimi-zbulimit, punimet e kryera në zonën e tij të lejuar (shoqëruar me vizatimet inxhinierike) dhe rezultatet e të gjitha provave të marra;

g) Raporti mbi pagesat për taksat vendore dhe kombëtare, në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse;

h) Informacionin për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve;

i) Informacion për licencat, autorizimet apo lejet përkatëse, të marra nga zotëruesi i lejes nëse për kryerjen e veprimtarisë së tij, një veprimi apo për përdorimin e një të mire publike në zonën e lejuar, që, sipas lejes nuk është pjesë e të drejtave të zotëruesit të lejes minerare, kërkohet miratim paraprak nga organet shtetërore;

j) Të mbajë në zyrat e shoqërisë të gatshme për inspektim nga SHGJSH-ja dhe t'i japë informacione dhe shpjegime kur këto kërkohen prej këtij institucioni.

2. Çdo zotërues i një leje minerare shfrytëzimi dhe/ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi duhet të përgatitë dhe të dorëzojë në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) informacionet e detyrueshme, sipas formatit, përcaktimeve të përmbajtjes dhe afatet e parashikuara në ligjin mineral nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Këto informacione të detyrueshme janë:

a) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e programit të investimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë ) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes;

b) Dokumenti i garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit në vazhdim;

c) Informacionet për pagesën e rentës minerare, sipas tipit të lejes minerare, në afatet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi për taksat dhe tatimet;

d) Informacionet 3 (tremujore) mbi realizimin e investimeve, punimeve minerare të realizuara dhe të gjitha operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor;

e) Informacionin vjetor për veprimtarinë financiare dhe teknike të realizuar dhe të gjitha operacioneve të kryera në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës, duke përfshirë dhe të gjitha masat e marra për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës;

f) Vlerësimin vjetor për vlerat e garancisë për zbatimin e planit të investimeve dhe të garancisë financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare që paraqitet çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data që i korrespondon hyrjes në fuqi të lejes për çdo vit në vazhdim për miratim;

g) Raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimtarisë minerare, duke dhënë në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë veprimtarisë minerare, punimet e kryera në zonën e tij të lejuar (shoqëruar me vizatimet inxhinierike) dhe rezultatet e planit të mbylljes, planit të rehabilitimit, planit të menaxhimit të mbetjeve dhe planit të monitorimit postminerar;

h) Raporti mbi pagesat për taksat vendore dhe kombëtare, në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse;

i) Informacionin për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve;

j) Informacion për licencat, autorizimet apo lejet përkatëse, të marra nga zotëruesi i lejes nëse për kryerjen e veprimtarisë së tij, një veprimi apo për përdorimin e një të mire publike në zonën e lejuar, që, sipas lejes nuk është pjesë e të drejtave të zotëruesit të lejes minerare, kërkohet miratim paraprak nga organet shtetërore;

k) Të mbajë në zyrat e shoqërisë të gatshme për inspektim nga SHGJSH-ja dhe t'i japë informacione dhe shpjegime kur këto kërkohen prej këtij institucioni.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

**URDHËR**  
**Nr.382, datë 20.5.2011**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE PROCEDURAVE TË LËNIES SË AKTIT TË KONSTATIMIT PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE NË ZBATIM TË LEJEVE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 45 pika 3 dhe nenit 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse dhe monitoruese për veprimtarinë minerare janë Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Reparti i Inspektim Shpëtimit të Minierave (RISHM).

2. Organizimi dhe funksionet e këtyre institucioneve janë të përcaktuara me ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Strukturat përgjegjëse kanë të drejtë të kryejnë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij legjislacionit minerar, të lënë detyra, të marrin masa administrative apo të propozojnë marrjen e tyre nga ministri.

4. Strukturat përgjegjëse kanë të drejtë të kërkojnë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë kanë dyshime se ai përdor praktika të dëmshme kërkimi, zbulimi apo shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, për respektimin e standardeve mjedisore të pranuara, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

5. Gjatë kontrollit të ushtruar në një zotërues të lejes minerare, punonjësit e strukturës përgjegjëse duhet të lënë menjëherë aktin e konstatimit të shkeljes së konstatuar duke përshkruar shkeljen.

6. Akti i konstatimit pasqyron punën kontrolluese të realizuara nga struktura përgjegjëse, bën evidentimin e shkeljeve ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative në zhvillimin e veprimtarive minerare në zbatim të legjislacionit minerar.

7. Akti i konstatimit plotësohet nga specialistët dhe inspektorët e strukturës përgjegjëse pas çdo kontrolli që kryejnë e për çdo shkelje që konstatojnë në subjektin minerar, duke përshkruar qartë shkeljen dhe masën e dënimit me gjobë që vendosin.

8. Akti i konstatimit mbahet në tri kopje, të cilat firmosen nga personat që kryejnë kontrollin dhe përfaqësuesi ligjor, teknik e administrativ i subjektit që kontrollohet. Në rast se përfaqësuesi i subjektit nuk firmos, shënohet fjala “refuzohet”. Një kopje e aktit të konstatimit i lihet subjektit, një kopje i dorëzohet titullarit të strukturës përgjegjëse, një kopje mbahet nga punonjësit që kryejnë aktin e konstatimit.

9. Forma e aktit të konstatimit, procedura e realizimit të tij përcaktohet në aneksin 1 bashkëngjitur këtij urdhri.

10. Sanksionet vendosen nga punonjësit e struktura përgjegjëse jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e konstatimit të shkeljes dhe njohjes së shkelësit, dhe i njoftohen me shkrim shkelësit.

11. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Gjoha paguhet brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.

13. Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt, i shkeljeve të parashikuara në shkronjat “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni, dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit.

14. Kryerja për herë të dytë nga i njëjti subjekt, i shkeljeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për veprimtarinë minerare, dënohet me dyfishin e gjobës dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin detyrimit sipas parashikimeve të këtij legjislacioni.

15. Strukturat përgjegjëse të sektorit minerar sigurojnë formimin dhe informimin për punonjësit e saj mbi përgjegjësitë dhe detyrat që duhet të realizojnë e të kryejnë për evidentimin e shkeljeve ligjore në veprimtarinë minerare që përbëjnë kundërvajtje administrative, për mënyrën dhe madhësinë e dënimit të tyre.

16. Strukturat përgjegjëse të sektorit minerar, specialistët dhe inspektorët e çdo strukture, në zbatim të detyrimit ligjor dhe autoritetit shtetëror, me program të planifikuar periodik ose të posaçëm, ushtrojnë kontrolle në çdo veprimtari minerare për të realizuar mbikëqyrjen e monitorimin e veprimtarive minerare dhe konstatimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të lejes minerare.

17. Titullarët e strukturës përgjegjëse në fillim të çdo viti kalendarik programojnë kontrollet për subjektet minerare të pajisura me leje minerare aktive gjatë atij viti kalendarik dhe e dërgojnë për miratim në METE. Çdo kontroll realizohet vetëm me miratim ose autorizim të titullarit. Përfshihen këtu rastet e kontrollit për raste aksidentesh, ku punonjësit e përcaktuar duhet të jenë në objekt menjëherë.

18. Kontrolle të veçanta ose të posaçme realizohen kur:

a) paraqiten rrethana të veçanta në një subjekt minerar, ose ka ankesa, që subjekti kryen veprimtari minerare në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit minerar në fuqi;

b) kur objektet minerare nuk janë vënë në punë sipas kushteve të lejes minerare apo programit vjetor të zhvillimit të punimeve;

c) në raste avarish;

d) në raste mosmarrëveshjes;

e) në raste ku vlerësohet moszbatim i detyrave të lëna nga struktura përgjegjëse;

f) me kërkesë të zotëruesit të lejes minerare;

g) me urdhër të organeve eprore të shtetit.

19. Në raste aksidentesh, punonjës nga strukturat përgjegjëse sipas funksioneve të tyre duhet të jenë në vendin e ngjarjes menjëherë.

20. Drejtoria përgjegjëse për veprimtarinë minerare në Ministri monitoron aktivitetin e kontrollit të institucioneve përgjegjëse në vartësi të Ministrisë.

21. Drejtoria përgjegjëse për veprimtarinë minerare në Ministri, në funksion të natyrës apo problematikës që haset gjatë zhvillimit të veprimtarisë minerare, bashkërendon punën e grupeve komplekse të kontrollit, me specialiste përfaqësues të disa institucioneve të vartësisë, të ngritura me urdhër të veçantë të Ministrit.

22. Për respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative, sanksionet dhe dënimi i tyre me gjobë konstatohen nga

titullari dhe inspektori i RISHM-it në zbatim të ligjit nr.8741, datë 15.2.2001 “Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.37, datë 28.1.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e RISHM-it” dhe rregullores së brendshme të RISHM-it të miratuar nga Ministri.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

ANEKSI 1  
AKT KONSTATIMI  
PËR KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE NË ZBATIM TË DETYRIMEVE TË LEJEVE MINERARE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I. VEPRIMTARIA MINERARE

E LIGJSHME \_\_\_\_\_

E PALIGJSHME \_\_\_\_\_

II. TË DHËNA MBI ZOTËRUESIN E LEJES MINERARE

- a) Emri i subjektit sipas QKR-së: .....
- b) Identifikimi i lejes minerare: leje minerare kërkim-zbulimi/shfrytëzimi/kërkim-zbulim-shfrytëzimi për grupin e mineraleve ..... nr....., datë...../...../.....
- c) Emri dhe mbiemri i zotëruesit të lejes: .....
- d) Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja: .....
- e) Adresa e selisë së subjektit: .....  
Qarku \_\_\_\_\_ rrethi \_\_\_\_\_
- f) Emri dhe mbiemri i administratorit: .....
- g) Nr. i telefonit /faksit: .....  
Adresa, qendër \_\_\_\_\_ filial \_\_\_\_\_
- h) Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti: .....
- i) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: .....
- j) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: .....

III. KONTROLLI

1. Data e fillimit të kontrollit për konstatimin e kundërvajtjeve administrative ../.../20\_\_
2. Data e përfundimit të kontrollit, konstatimit të shkeljeve dhe njoftimit ../.../20\_\_
3. Përfaqësuesi i subjektit në kontroll dhe marrësi i njoftimit \_\_\_\_\_

IV. KRYEN KONTROLLIN PËR KONSTATIMIN E KUNDËRVAJTJEVE – ADMINISTRATIVE  
Struktura përgjegjëse (SHGJSH/AKBN/RISHM)

|   | Emër, mbiemër | Struktura përgjegjëse | Pozicioni i punës |
|---|---------------|-----------------------|-------------------|
| 1 |               |                       |                   |
| 2 |               |                       |                   |
| 3 |               |                       |                   |
| 4 |               |                       |                   |
| 5 |               |                       |                   |

V. Objekti i kontrolluar \_\_\_\_\_, lloji i inspektimit \_\_\_\_\_ (i programuar, tematik, për rast aksidentesh).

VI. Përshkrimi i kontrollit të realizuar dhe shkeljet e konstatuara.

VII. VLERËSIMI LIGJOR I KUNDËRVAJTJES ADMINISTRATIVE NË VEPRIMTARINË MINERARE

Përshkrimi i shkeljes së parë

- a) Është shkelur ligji nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” në nenin ....., pika.....
- b) Është shkelur vendimi i Këshillit të Ministrave nr....., datë ../.../..... në nenin ....., pikën.....

- c) Është shkelur urdhri i Ministrit nr....., datë .../.../..... në nenin ....., pikën.....  
d) Është shkelur urdhri i Ministrit nr....., datë .../.../..... në nenin ....., pikën.....  
e) Është shkelur detyrimi i lejes minerare me përshkrimin e mëposhtëm:

- f) Merret masa  
i) Gjykitje në vlerë .....,  
ii) Pezullim për një periudhë kohore....., duke i kërkuar rregullim të shkeljes për një periudhë kohore.....  
iii) Propozim për heqje të lejes minerare.....

**Përshkrimi i shkeljes së dytë**

- a) Është shkelur ligji nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” në nenin ....., pika.....  
b) Është shkelur vendimi i Këshillit të Ministrave nr....., datë .../.../..... në nenin ....., pikën.....  
c) Është shkelur urdhri i Ministrit nr....., datë .../.../..... në nenin ....., pikën.....  
d) Është shkelur urdhri i Ministrit nr....., datë .../.../..... në nenin ....., pikën.....  
e) Është shkelur detyrimi i lejes minerare me përshkrimin e mëposhtëm:

- f) Merret masa  
i) Gjykitje në vlerë .....,  
ii) Pezullim për një periudhë kohore....., duke i kërkuar rregullim të shkeljes për një periudhë kohore.....  
iii) Propozim për heqje të lejes minerare.....

**VIII. NËNSHKRIMI I AKTIT TË KONSTATIMIT**

| Konstatuesit e kundërvajtjeve          |       | Subjekti minerar i ndëshkuar për kundërvajtje |       |
|----------------------------------------|-------|-----------------------------------------------|-------|
| Emër, mbiemër<br>Struktura përgjegjëse | Firma | Zotëruesi i lejes minerare                    | Firma |
| Emër, mbiemër<br>Struktura përgjegjëse | Firma | Administratori                                | Firma |
| Emër, mbiemër<br>Struktura përgjegjëse | Firma | Drejtuesi teknik                              | Firma |

**URDHËR**  
**Nr.383, datë 20.5.2011**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË PLANIT TË VEPRIMTARIVE PËR MBYLLJEN E NJË VEPRIMTARIE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 53, pika 7 dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Plani për mbylljen e veprimtarisë minerare është pjesë e planit të rehabilitimit të zonës minerare, si kapitull i veçantë i tij dhe përfshin tërësinë e dokumentacionit teknik, ekonomik dhe të mjedisit.
2. Plani për mbylljen e veprimtarisë minerare përgatitet nga aplikuesi për marrjen e një leje minerare dhe hartohet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar në fushën e veprimtarive studimore projektuese në fushën minerare. Ky plan hartohet në përputhje me parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të veprimtarisë minerare që mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.



3. Plani për mbylljen e veprimtarisë minerare së një miniere të braktisur, të shfrytëzuar nga ish-ndërmarrjet shtetërore, apo të një objekti minerar kërkim-zbulimi me puse shpimi të realizuar nga shteti, hartohet nga strukturat përgjegjëse, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për zonat e kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për zonat e shfrytëzimit.

4. Të gjitha minierat e braktisura që vlerësohen si të tilla, sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, kalojnë në regjim mbylljeje dhe monitorimi postminerar pas studimeve vlerësuese të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe së bashku me shpenzimet financiare për këto mbyllje, që përballohen nga buxheti i shtetit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. AKBN-ja i propozon ministrit zonat minerare për mbyllje të veprimtarisë minerare, në bazë të një plani për mbylljen e veprimtarisë minerare. Ky plan duhet të argumentojë dhe justifikojë mbylljen e veprimtarisë minerare dhe duhet të përfshijë veprimet e nevojshme, sipas afateve, duke garantuar financimin për marrjen e masave efektive për mbylljen e minierës, në bazë të kërkesave të legjislacionit minerar dhe mjedisor në fuqi,

6. Të gjitha minierat e braktisura nga zotëruesit e lejeve minerare, kalojnë në regjim mbylljeje dhe monitorimi postminerar pas studimeve vlerësuese të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit përdoret për realizimin e këtij plani.

7. Planin për mbylljen e veprimtarisë minerare për zonat e lejeve minerare të braktisura nga zotëruesi i lejes minerare dhe minierave të shfrytëzuara nga shteti zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore, ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontrollon dhe monitorohet nga SHGJSH-ja për zonat e kërkim-zbulimit dhe AKBN-ja për zonat e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

8. Procedurat për mbylljen e veprimtarisë minerare të një objekti minerar bëhet sipas planit për mbylljen e veprimtarisë minerare të miratuar, në zbatim të kërkesave të nenit 53 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

9. Planin për mbylljen e veprimtarisë minerare duhet të mbështetet në parimet e:

a) Garantimit të eliminimit të efekteve të dëmshme nga veprimtaria minerare në jetën dhe shëndetin e komunitetit të zonave minerare në të ardhmen për një periudhë sa më të gjatë;

b) Garantimit të eliminimit nga veprimtaria minerare të efekteve të dëmshme të ndotjes në tokë, në ujëra, të florës e faunës dhe në ekosistemin në përgjithësi nga shkarkimet dhe emetimet në të ardhmen për një periudhë sa më të gjatë, si dhe të respektimit të standardeve minimale, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare dhe mjedisin;

c) Mbylljes progresive të veprimtarisë minerare, duke eliminuar efektet e kësaj veprimtarie gjatë periudhës së lejes minerare;

d) Garantimit të mbylljes së sigurt të veprimtarisë minerare;

e) Garantimit të demolimit të sigurt të objekteve të veprimtarisë minerare, që nuk mund të përdoren më tej, pas përfundimit të kësaj veprimtarie, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

f) Realizimit të përfundimit të procesit të mbylljes së objekteve minerare të ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare;

g) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore;

h) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

10. Planin për mbylljen e veprimtarisë minerare duhet të përmbajë:

a) Projektin e mbylljes së veprimtarisë minerare që duhet të realizohet, duke pasur parasysh:

i) përshkrim të përgjithshëm të territorit, florës dhe faunës;

ii) përshkrim të objektit minerar të shfrytëzuar, punimeve kapitale dhe ndihmëse, objektet sipërfaqësore, impiantet e përpunimit dhe riciklimit dhe sheshin e depozitimit të mbetjeve, rezervat e shfrytëzuara apo të mbetura;

iii) përbërjen e mbetjeve minerare dhe karakteristikat fiziko-kimike të tyre;

iv) lëvizjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore;

v) afërsinë me infrastrukturën dhe zonat e banuara;

vi) ndikimin e objektit minerar të mbyllur në jetën e shëndetin e komunitetit të zonës minerare;

vii) ndikimin në ekosistemin e zonës minerare dhe asaj përreth saj;

viii) ndikimin në ekosistemin në përgjithësi;

ix) nivelin e shkarkimeve në mjedis dhe ndotjen që shkakton tek ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, të florës e të faunës, objekti minerar në të ardhmen pas mbylljes;

x) trajtimin në të ardhmen pas mbylljes së ujërave e të gazrave, që dalin nga miniera;  
xi) kolonat mbrojtëse, që janë pjesë të burimeve/rezervave minerare ose të shkëmbinjve rrethues, të cilat nuk janë shfrytëzuar për mbrojtjen e nëntokës e të sipërfaqes së zonës minerare;

xii) mënyrën e mbrojtjes së argjinaturave të lumenjve ose sipërfaqeve të tjera dhe përfshihen në zonën e rrezikshme të një të drejte minerare.

b) Parashikimin për procedurat dhe afatet kohore të realizimit të punimeve të procesit të mbylljes së minierës, karrierës, impianteve të përpunimit, impianteve të riciklimit dhe sheshit të depozitimit.

c) Realizimin progresiv të procesit të mbylljes së veprimtarisë minerare, kur kjo është e parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare.

d) Mundësitë e aksidenteve dhe rrezikshmërisë së objektit mineral pas mbylljes.

e) Për veprimtaritë minerare, mbetet e të cilave rezultojnë nga procese ku përdoren lëndë toksike dhe të rrezikshme, si: cianure, acide, substanca kimike të rrezikshme, plani i mbylljes së veprimtarisë minerare duhet, gjithashtu, të përfshijë dhe eliminimin e këtyre lendeve toksike dhe të rrezikshme.

11. Dokumentet informative që mbahen nga strukturat përgjegjëse apo subjektet e përzgjedhura për realizimin e planit për mbylljen e veprimtarisë minerare duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit mineral dhe atij mjedisor në fuqi dhe duhet të përmbajnë, gjithashtu:

a) Gent planin e punimeve të mbylljes të objektit mineral për zonën e lejuar minerare dhe të sheshit të depozitimit të sterileve, sipas projektit të miratuar;

b) Gent planin e punimeve të mbylljes për impiantin e përpunimit dhe riciklimit;

12. Forma dhe përmbajtja tip e “planit për mbylljen e veprimtarisë minerare” për lejet e kërkim-zbulimit do të jetë sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

13. Forma dhe përmbajtja tip e “planit për mbylljen e veprimtarisë minerare” për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit do të jetë sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

14. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucionet e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore (AKBN), Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

#### ANEKSI NR.1

#### FORMA DHE PËRMBAJTJA TIP E “PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË MBYLLJES SË VEPRIMTARISË MINERARE” PËR LEJET E KËRKIM-ZBULIMIT

##### I. PËRMBAJTJA E TEKSTIT

1. Konsiderata të përgjithshme

2. Të dhëna mbi subjektin kur plani hartohet për një zonë të re minerare:

i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

ii) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën kërkohet leja minerare dhe që përfshihet në planin vjetor mineral të miratuar për vitin .....

iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënia e lejes: .....

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR: .....

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

vi) Nr. i telefonit /faksit: .....

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....

viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: .....

ix) Data e përfundimit të licencës profesionale së drejtuesit teknik: ...../...../.....

3. Të dhëna mbi objektin mineral

A. kur objekti mineral është braktisur nga zotëuesi i lejes minerare:

i) Zona minerare me numër identifikues nr....., e përfshirë në planin vjetor mineral të miratuar për vitin ..... dhe licencuar me lejen minerare nr....., datë...../...../.....

ii) Emri i subjektit zotëues i lejes minerare sipas regjistrimit në QKR: .....

iii) Lloji i mineralit/mineraleve: .....

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

- v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
- vi) Nr. i telefonit /faksit: .....
- vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....
- B. Kur objekti mineralar është një minierë e braktisur dhe shfrytëzuar nga ish-ndërmarrjet shtetërore:
- i) Zona minerare me numër identifikues nr.....,
- ii) Emri i subjektit shtetëror që është pronar i aseteve të objektit mineralar .....
- iii) Lloji i mineralit/mineraleve: .....
- iv) Nr. i telefonit /faksit të subjektit shtetëror: .....
- v) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....
4. Baza ligjore, mbi të cilën hartohet projekti:  
Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton kalimin në regjim mbylljeje të objektit mineralar.
5. Të dhëna të përgjithshme të shkurtra për objektin mineralar (sipas projektit të shfrytëzimit):
- a) Vendndodhja administrative dhe topografike e objektit.
- b) Gjeografia e zonës, relievi, bimësia, fauna, ekosistemi në përgjithësi etj.
- c) Ndërtimi gjeologjik i rajonit dhe vendburimit.
- d) Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike të vendburimit. Llojet e ujërave dhe kimizimi i tyre.
- e) Përshkrimi i mënyrës së kryerjes së veprimtarisë së kërkim-zbulimit, punimet kryesore, pusët, transhetë, galeritë, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedh nga punimet minerare, sasia dhe përbërja mineralogjike e sterileve, vendndodhja e shesheve të depozitimit.
- f) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore, si: rrugë, puse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materiale, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.
6. Inventari i investimeve të kryera në objektin mineralar:
- a) Inventari fizik faktik i miratuar;
- b) Inventari i punimeve themelore, përgatitore dhe të kërkim-zbulimit;
- c) Inventari kontabël (i miratuar nga bilanci kontabël).
7. Parashikimi i mënyrës dhe operacioneve të mbylljes së minierës:
- a.1. Mbyllje tërësore që përfshin:
- Mbylljen e grykave të galerive gjeologjike dhe puseve e pusëzave.
  - Mbushjen e plotë të hapësirave të krijuara nga trashet në sipërfaqe.
  - Zbatimi i planit të rehabilitimit, sipas urdhrin nr.... datë,.....
- a.2. Mbyllje e pjesshme:
- Mbylljen e grykave të galerive,
  - Zbatimi i planit të rehabilitimit progresiv, sipas urdhrin nr.... datë,.....
8. Zgjedhja dhe përshkrimi i detajuar i mënyrës së mbylljes.
9. Preventivi i detajuar dhe i specifikuar për çdo operacion për mënyrën e zgjedhur të mbylljes.
10. Hartimi i preventivit përfundimtar të mbylljes.
11. Hartimi i grafikut të zbatimit të planit të veprimeve të mbylljes.
12. Përfundime dhe rekomandime.

## II. PJESA GRAFIKE

| Nr. | Emërtimi                                                                                                                           | Shkalla                                 |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|
| 1   | Harta topografike me zonën e kërkuar                                                                                               | 1:25000                                 |
| 2   | Planimetria e përgjithshme me punimet gjeologjike (të azhurnuara me gjendjen përfundimtare)                                        | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000 ose 1:500 |
| 3   | Profilat tërthore gjeologo-topografike (të azhurnuar me gjendjen përfundimtare, gjurmët e trupit të mineralizuar)                  | 1:1000 ose 1:2000, 1:500 ose 1:200      |
| 4   | Projeksioni vertikal me gjeometrizimin e trupit dhe/ose trupave apo zonës së mineralizuar (të azhurnuar me gjendjen përfundimtare) | 1:1000 ose 1:2000, 1:500 ose 1:200      |
| 5   | Pasaportat e mbylljes së punimeve gjeologjike                                                                                      |                                         |
| 6   | Skema e rrethimit nëse kërkohet si e nevojshme dhe e vendosjes së sinjalistikës parandaluese                                       | 1:500 ose 1:200                         |

## ANEKSI NR.2

### FORMA DHE PËRMBAJTJA TIP E "PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË MBYLLJES SË VEPRIMTARISË MINERARE" PËR LEJET E SHFRYTËZIMIT DHE LEJET E KËRKIM-ZBULIM-SHFRYTËZIMIT

#### I. PËRMBAJTJA E TEKSTIT

##### 1. Konsiderata të përgjithshme

##### 2. Të dhëna mbi subjektin kur plani hartohet për një zonë të re minerare:

- i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
- ii) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën kërkohet leja minerare dhe që përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin .....
- iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënia e lejes: .....
- iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR: .....

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

vi) Nr. i telefonit /faksit: .....

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....

viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: .....

ix) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: ...../...../.....

##### 3. Të dhëna mbi objektin minerar

##### A. Kur objekti minerar është braktisur nga zotëruesi i lejes minerare:

i) Zona minerare me numër identifikues nr....., e përfshirë në planin vjetor minerar të miratuar për vitin .....dhe licencuar me lejen minerare nr....., datë.../.../.....

ii) Emri i subjektit zotërues i lejes minerare sipas regjistrimit në QKR: .....

iii) Lloji i mineralit/mineraleve: .....

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

vi) Nr. i telefonit /faksit: .....

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....

##### B. Kur objekti minerar është një minierë e braktisur dhe shfrytëzuar nga ish-ndërmarrjet shtetërore:

i) Zona minerare me numër identifikues nr.....,

ii) Emri i subjektit shtetëror që është pronar i aseteve të objektit minerar .....

iii) Lloji i mineralit/mineraleve: .....

iv) Nr. i telefonit /faksit të subjektit shtetëror: .....

v) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....

##### 4. Baza ligjore mbi të cilën hartohet projekti:

Vendimin e Këshillit të Ministrave, që miraton kalimin në regjim mbyllje të objektit minerar.

##### 5. Të dhëna të përgjithshme të shkurtra për objektin minerar (sipas projektit të shfrytëzimit):

- a) Vendndodhja administrative dhe topografike e objektit;
- b) Gjeografia e zonës, relievi, bimësia, fauna, ekosistemi në përgjithësi etj.;
- c) Ndërtimi gjeologjik i rajonit dhe vendburimit;
- d) Lloji dhe trashësia e mbulesës së tokës në zonën minerare;
- e) Tektonika e vendburimit;
- g) Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike të vendburimit. Llojet e ujërave dhe kimizimi i tyre;
- h) Mbi morfologjinë dhe përbërjen e xeherorit dhe/ose xeheroreve të dobishëm. Të dhëna të shkurtra mbi llojin e mineralit, vetitë fiziko-kimike të tij.

##### A. Për rastin e shfrytëzimit nëntokësor të vendburimit

a) Përshkrimi i mënyrës së hapjes së minierës, punimet kryesore të hapjes, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedhin nga punimet minerare, sasia dhe përbërja mineralogjike e sterileve, vendndodhja e shesheve të depozitimit, impianteve të përpunimit dhe riciklimit;

b) Sistemi i shfrytëzimit të përdorur dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar, sasia dhe cilësia e rezervave të shfrytëzuara ose që mund të shfrytëzohen të ndarë sipas horizonteve dhe profileve;

c) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore, si: rrugë, puse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materiale, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.

##### B. Për rastin e shfrytëzimit me karrierë të vendburimit:

a) Përshkrimi i varianteve të hapjes së rrugëve dhe gjysmëtrasheve, gjatësia dhe seksioni i tyre.

Përcaktimi i kufijve faktikë të karrierës, dimensionet reale të saj, përcaktimi i koordinatave të vertekseve, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedhin në karrierë dhe që dalin prej saj, vendndodhja e shesheve të depozitimit të mbetjeve, vendndodhja e impianteve të përpunimit dhe riciklimit;

b) Sistemi i shfrytëzimit që është përdorur dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar, sasia dhe cilësia e rezervave të shfrytëzuara, ose që mund të shfrytëzohen të ndarë sipas horizonteve dhe profileve;

c) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore, si: rrugë, puse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materiale, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.

6. Inventari i investimeve të kryera në objektin minierar:

- a) Inventari fizik faktik i miratuar;
- b) Inventari i punimeve themelore, përgatitore dhe të shfrytëzimit;
- c) Inventari kontabël (i miratuar nga bilanci kontabël);
- d) Lista e makinerive e pajisjeve teknologjike;

7. Parashikimi mënyrës dhe operacioneve të mbylljes të minierës:

a) Për rastin shfrytëzimit nëntokësor:

a.1. Mbyllje tërësore e minierës do të thotë:

- Mbylljen e grykave të punimeve të hapjes së minierës;
- Mbushjen e plotë të hapësirave të krijuara nga shfrytëzim dhe muldave (hinkave) në sipërfaqe;
- Rrethimin e zonave të rrezikshme;
- Vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndaluese;
- Zbatimi i planit të rehabilitimit, sipas urdhrin nr...., datë.....

a.2. Mbyllje e pjesshme e minierës:

- Mbylljen e grykave të punimeve të hapjes;
- Rrethimin e zonave të rrezikshme;
- Vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndaluese;
- Zbatimi i planit të rehabilitimit, sipas urdhrin nr...., datë.....

b) Për rastin e shfrytëzimit me karrierë:

- Mbyllja dhe/ose bllokimi i rrugëve, trasheve ose gjysmëtrasheve të hyrjes në karrierë;
- Rrethimi i hapësirës dhe/ose hapësirave së krijuar nga shfrytëzimi me karrierë;
- Vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndaluese;
- Zbatimi i planit të rehabilitimit, sipas urdhrin nr...., datë...

8. Zgjedhja dhe përshkrimi i detajuar i mënyrës së mbylljes.

9. Preventivi i detajuar dhe specifikuar për çdo operacion për mënyrën e zgjedhur të mbylljes.

a. Për rastin e minierave nëntokë:

- Për mbylljen e grykave të punimeve kryesore;
- Për mbushjen e hapësirave nëntokë;
- Për mbushjen e muldave (hinkave në sipërfaqe);
- Për rrethimin e hapësirave të rrezikshme;
- Për sinjalistikën;
- Për zbatimin e planit të rehabilitimit;
- Për çmontim të ndryshme mekanike dhe elektrike;
- Për kryerjen e proceseve të tjera ndihmëse, si heqje ujërash, transport punonjësish materiale, makineri e pajisje etj.;

- Çmontime makineri dhe pajisjesh mekanike edhe elektrike në nëntokë dhe sipërfaqe;

- Projektorganizimi për çmontimin e makinerive dhe pajisjeve të impiantit të pasurimit ose fabrikës së pasurimit (nëse ka të tilla);

- Shpenzime të tjera për likuidimin e minierës;
- Probleme dhe detyra të influencës së shfrytëzimit në sipërfaqe për fushën;
- Likuidimi i objekteve sipërfaqësore;
- Monitorimi pas likuidimit të minierës;
- Masat e sigurimit teknik për kryerjen e punimeve të likuidimit dhe proceseve të tjera ndihmëse.

b) Për rastin e karrierave:

- Për mbylljen dhe/ose bllokimin e rrugëve, trasheve ose gjysmëtrasheve të hyrjes në karrierë;
- Për rrethimin e hapësirës dhe/ose hapësirave së krijuar nga shfrytëzimi me karrierë;
- Për vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndaluese;
- Për zbatimin e planit të rehabilitimit;
- Për çmontim të ndryshme mekanike dhe elektrike;

- Për kryerjen e proceseve të tjera ndihmëse, si: heqje ujërash, transport punonjësish materiale, makineri e pajisje etj.;
  - Çmontime makineri dhe pajisjesh mekanike edhe elektrike në sipërfaqe;
  - Projektorganizimi për çmontimin e makinerive dhe pajisjeve të impiantit të pasurimit ose fabrikës së pasurimit (nëse ka të tilla);
  - Shpenzime të tjera për likuidimin e minierës;
  - Probleme dhe detyra të influencës së shfrytëzimit në sipërfaqe për fushën;
  - Likuidimi i objekteve sipërfaqësore;
  - Monitorimi pas likuidimit të minierës;
  - Masat e sigurimit teknik për kryerjen e punimeve të likuidimit dhe proceseve të tjera ndihmëse.
10. Hartimi i preventivit përfundimtar të mbylljes.
11. Hartimi i grafikut të zbatimit të planit të veprimeve të mbylljes.
12. Përfundime dhe rekomandime.

## II. PJESA GRAFIKE

| Nr. | Emërtimi                                                                                                                                                                                         | Shkalla                                   |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| A.  | Për minierat nëntokësore                                                                                                                                                                         |                                           |
| 1   | Harta topografike me zonën e kërkuar                                                                                                                                                             | 1:25000                                   |
| 2.  | Planimetria e përgjithshme me punimet e hapjes (të azhuruara me gjendjen përfundimtare)                                                                                                          | 1:5000, ose 1:2000 ose 1:1000, ose 1:500  |
| 3.  | Planimetritë e çdo horizonti (të azhuruara me gjendjen përfundimtare dhe gjurmët e trupit të shfrytëzuar)                                                                                        | 1:1000 ose 1:2000 ose 1:500 ose 1:200     |
| 4   | Profillet tërthore gjeologo-topografike (të azhuruara me gjendjen përfundimtare, gjurmët e trupit të shfrytëzuar dhe hapësirat e shfrytëzimit)                                                   | 1:1000 ose 1:2000, 1:500, ose 1:200       |
| 5   | Projeksioni vertikal me gjeometrizimin e trupit dhe/ose trupave apo zonës së mineralizuar (të azhuruara me gjendjen përfundimtare, gjurmët e trupit të shfrytëzuar dhe hapësirat e shfrytëzimit) | 1:1000 ose 1:2000, 1:500, ose 1:200       |
| 6   | Harta topografike me zonën e shfrytëzuar me dokumentimin e infrastrukturës së aktualizuar dhe zonës apo zonave të shembura ose që ndodhen nën influencën shfrytëzimit (e azhuruara)              | 1:5000, ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 7   | Planimetria e vendosjes së objekteve administrative, social-kulturore dhe industriale (e azhuruara me gjendjen përfundimtare)                                                                    | 1:500, ose 1:200                          |
| 8   | Pasaportat e mbylljes së punimeve minerare                                                                                                                                                       |                                           |
| 9   | Pasaporta e mbushjes së hapësirave nëntokë dhe/ose muldave (hinkave në sipërfaqe)                                                                                                                |                                           |
| 10  | Skema e rrethimit dhe vendosjes së sinjalistikës parandaluese                                                                                                                                    |                                           |
| B.  | Për karrierat                                                                                                                                                                                    |                                           |
| 1   | Harta topografike me zonën e kërkuar                                                                                                                                                             | 1:25000                                   |
| 2   | Planimetria e përgjithshme e karrierës në fund të shfrytëzimit e azhuruara me gjendjen përfundimtare                                                                                             | 1:1000 ose 1:2000 ose 1:500               |
| 3   | Profillet tërthore të zhvillimit të shkalleve të karrierës e azhuruara me gjendjen përfundimtare                                                                                                 | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500              |
| 4   | Harta gjeologo-topografike e objektit me rrugët e hapjes dhe sheshet e depozitimit të sterileve apo nënprodukteve, me gjendjen përfundimtare                                                     | 1:5000, ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 5   | Planimetria e vendosjes së objekteve administrative, social-kulturore dhe industriale dhe skema e vendosjes së makinerive dhe pajisjeve në sheshin e punës                                       | 1:100, 1:200 ose skematike me parametra   |
| 6   | Pasaportat e mbylljes së rrugëve hyrëse në karrierë                                                                                                                                              | 1:500, ose 1:200                          |
| 7   | Skema e rrethimit të hapësirës së karrierës dhe vendosjes së sinjalistikës parandaluese                                                                                                          |                                           |

## URDHËR

Nr.384, datë 20.5.2011

### PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT DHE DOKUMENTACIONIT QË REGJISTROHET NË KADASTRËN MINERARE DHE NË REGJISTRIN MINERAR, SI DHE FORMA DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË KËTIJ DOKUMENTACIONI NGA ANA E ZOTËRUESVE TË LEJEVE MINERARE

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 44, pika 2 dhe nenit 56, pika 2, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”,

## URDHËROJ:

1. Regjistri minerar përfshin të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësinë, situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të

veprimtarisë minerare, për rezervat dhe për prodhimin minerar, si dhe të dhënat për zotëruesin e lejeve minerare, si më poshtë:

A. Të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje:

a) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën është miratuar leja minerare dhe që përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin ..... dhe licencuar me lejen minerare nr....., datë.../.../.....

b) Lloji i mineralit/mineraleve, për të cilin është dhënë leja: .....

c) Sipërfaqja e zonës së lejuar të lejes minerare në km<sup>2</sup>: .....

d) Harta e zonës së lejuar të lejes minerare me koordinatat shtetërore në plan, regjimi i saj juridik sipas aktit të verifikimit të strukturës përgjegjëse (një kopje e saj origjinale).

e) Harta e zonës së lejuar të lejes minerare me koordinatat shtetërore në plan, e miratuar nga struktura përgjegjëse sipas vendimit të këshillit teknik (një kopje e saj origjinale).

f) Harta e zonave fqinje me zonën e lejuar të lejes minerare, regjimi i tyre juridik sipas aktit të verifikimit të strukturës përgjegjëse (një kopje e saj origjinale).

g) Akti i miratimit të lejes minerare që përgatitet nga drejtoria përgjegjëse në METE që mbulon veprimtarinë minerare dhe miratohet nga Ministri;

h) Format i lejes që publikohet nga institucioni i QKL-së;

i) Emërtimi i njësive vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e lejuar e lejes minerare: ..

B. Të dhënat për pronësinë e tokës të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje:

a) Akti i pronësisë së sipërfaqes së tokës së zonës së lejuar minerare apo ndryshimit të kësaj pronësie pas miratimeve nga strukturat përkatëse sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

b) Akti i pronësisë së sipërfaqes së tokave fqinje me zonën e lejuar minerare apo ndryshimit të pronësive të tyre pas miratimeve nga strukturat përkatëse sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

c) Akti i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të tokës pas miratimeve nga strukturat përkatëse sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

C. Të dhënat për situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë minerare, sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar dhe të përditësuar:

Për lejet minerare të kërkim-zbulimit:

a) Vendndodhja administrative;

b) Gjeografia e zonës, relievi, klima, bimësia;

c) Ndërtesat dhe objekte të infrastrukturës në zonën e lejuar;

d) Hidrografia, hidrogeologjia;

e) Demografia;

f) Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore;

g) Përshkrim i punimeve të kërkim-zbulimit;

h) Skema e furnizimit me ujë;

i) Skema e furnizimit me energji elektrike;

j) Skema e transportit të përgjithshëm;

k) Pasqyra përmbledhëse e pajisjeve dhe mekanizmave të përdorur në nëntokë dhe sipërfaqe;

l) Tabela përmbledhëse e investimeve;

m) Harta topografike me zonën e kërkuar me dokumentimin e infrastrukturës së aktualizuar (e azhurnuar);

n) Harta gjeologo-topografike me punimet e kryera për kërkim-zbulimin e xeherorit (kanale, puse, galeri shpime);

o) Planimetria e përgjithshme e minierës me punimet e kërkim-zbulimit, rrugët, sistemimet, vendosjen e objekteve sipërfaqësore dhe sheshet e depozitimit të sterileve, e projektuar.

Për lejet minerare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit:

a) Vendndodhja administrative;

b) Gjeografia e zonës, relievi, klima, bimësia;

c) Ndërtesat dhe objekte të infrastrukturës në zonën e lejuar;

d) Hidrografia, hidrogeologjia;

e) Demografia;

f) Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore;

g) Përshkrim i sistemit të shfrytëzimit;

h) Përshkrim i proceseve të seleksionimit, thyerjes, fraksionizmit, pasurimit apo metodave të tjera që do të përdoren për përpunimin e mineralit dhe realizimin e produkteve të parashikuara, me skemat përkatëse teknologjike dhe treguesit;

- i) Punimet e hapjes së objektit mineralar kapitale dhe ndihmëse, parametrat e tyre;
  - j) Punimet e shfrytëzimit të objektit mineralar, parametrat e tyre;
  - k) Pasaportat e shpim-plasjes;
  - l) Skema e ajrimit;
  - m) Skema e furnizimit me ajër të ngjeshur;
  - n) Skema e furnizimit me ujë;
  - o) Skema e furnizimit me energji elektrike;
  - p) Skema e transportit të përgjithshëm;
  - q) Pasqyra përmbledhëse e pajisjeve dhe mekanizmave të përdorur në nëntokë dhe sipërfaqe;
  - r) Tabela përmbledhëse e investimeve;
  - s) Harta topografike me zonën e kërkuar me dokumentimin e infrastrukturës së aktualizuar (e azhurnuar);
  - t) Harta gjeologo-topografike me punimet e kryera për shfrytëzimin e xeherorit (puse, galeri etj.);
  - u) Planimetria e përgjithshme e minierës me punimet e hapjes. Harta topografike e sipërfaqes së minierës me rrugët, sistemit, vendosjen e objekteve sipërfaqësore dhe sheshet e depozitimit të sterileve apo nënprodukteve, e projektuar;
  - v) Harta topografike e vendburimit me konturet e zonave të rrezikshme nga influenca e shfrytëzimit;
  - w) Planimetria e përgjithshme e objekteve të përpunimit të mineralit.
- D. Të dhënat për rezervat dhe për prodhimin mineralar sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë mineralare, të miratuar dhe të përditësuar:
- Për lejet mineralare të kërkim-zbulimit:
- a) Rezervat sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre;
  - b) Metoda e llogaritjes së rezervave dhe tabela e llogaritjes së rezervave të mineralit; rezervat gjeologjike dhe të nxjerrshme të mineralit në sasi e cilësi;
  - c) Të dhëna mbi mineralizimin dhe karakteristikat e trupave xeherorë;
  - d) Përmbajtja e elementeve të dobishme.
- Për lejet mineralare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit:
- a) Rezervat sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre;
  - b) Metoda e llogaritjes së rezervave dhe tabela e llogaritjes së rezervave të mineralit; rezervat gjeologjike dhe të nxjerrshme të mineralit në sasi e cilësi;
  - c) Të dhëna mbi mineralizimin dhe karakteristikat e trupave xeherorë;
  - d) Përmbajtja e elementeve të dobishme;
  - e) Rezervat e shfrytëzuara, të gatshme dhe të zbuluara.
- E. Të dhënat për zotëruesin e lejeve mineralare:
- a) Emri i subjektit mineralar që është zotërues i lejes mineralare sipas regjistrimit në QKR: (një kopje e ekstraktit të QKR-së për shoqërinë në momentin e dhënies së lejes, e cila duhet të përditësohet duke reflektuar ndryshimet në këtë ekstrakt gjatë afatit të lejes mineralare dhe në përfundim të këtij afati).
  - b) Emri/emrat e pronarëve të kompanisë mineralare, zotëruese e lejes mineralare, sipas përqindjeve të tyre në kompani sipas regjistrimit në QKR: ..... (përqindjet e aksionarëve në shoqëri në momentin e dhënies së lejes, e cila duhet të përditësohet duke reflektuar ndryshimet në këtë ekstrakt gjatë afatit të lejes mineralare dhe në përfundim të këtij afati). Kur zotëruesi/zotëruesit kryesorë të aksioneve të kompanisë ndryshojnë, ndryshimet në regjistrin mineralar duhet të reflektojnë aktin e transferimit të lejes.
  - c) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit zotërues i lejes mineralare sipas regjistrimit në QKR: .....
  - d) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
  - e) Nr. i telefonit /faksit: .....
  - f) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: .....
  - g) Të dhëna për licencën profesionale të drejtuesit teknik: data e lëshimit ...../...../....., institucioni që ka lëshuar licencën .....
  - h) Emri i personit dhe nr. i telefonit për raste emergjencash dhe aksidentesh: .....
2. Të dhënat që përshihen në regjistrin mineralar që kanë të bëjnë me:
- i) situatën topografike të zonave mineralare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë mineralare;
  - ii) rezervat për prodhimin mineralar dorëzohen nga zotëruesit e lejes në momentin e aplikimit për një leje mineralare dhe depozitohen pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL).
3. Të dhënat për zotëruesin e lejeve mineralare pas aktit të miratimit të ministrit, dërguar pranë institucionit të QKL-së, nga drejtoria përgjegjëse në METE për veprimtarinë mineralare mbahen po nga ky institucion.



4. Të dhënat që përshihen në regjistrin mineral që kanë të bëjnë me regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësinë, vlerësohen në aktin e verifikimit dhe vendimin e Këshillit Teknik nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për zonat e kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për zonat e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit, dhe dërgohen në QKL.

5. Drejtoria përgjegjëse në METE për veprimtarinë minerare, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) kanë të drejtë të disponojnë *on-line* të dhënat që lidhen me objektin e punës së veprimtarisë së tyre.

6. Regjistri mineral për çdo leje minerare përfshin, gjithashtu, të dhëna për kundërvajtjet administrative të zotëruesit të lejes minerare, statusin e lejes minerare, pezullimi apo në procedurë revokimi.

7. Në regjistrin mineral përfshihen, gjithashtu, të gjitha zonat minerare që janë mbyllur ose janë në proces mbylljeje apo konservimi.

8. Institucioni i QKL-së mban regjistrin mineral, duke lidhur të gjitha të dhënat për një zonë minerare me të dhënat e zotëruesit të lejes minerare dhe realizon administrimin e këtyre të dhënave për strukturat përgjegjëse të veprimtarisë minerare në bazë të akteve ligjore të funksionimit të kësaj qendre.

9. Ndryshimet për zotëruesin e lejes minerare që realizohen nga transferimi i lejes, duhet të reflektohen në regjistrin mineral brenda një periudhe jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e aktit të transferimit.

10. Ndryshimet e administratorit dhe drejtuesit teknik të realizuara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) nga ana e subjektit mineral dhe të reflektuara në ekstraktin e subjektit mineral në QKR, duhet të reflektohen automatikisht nga QKL-ja në regjistrin mineral.

11. Kadastra minerare përfshin inventarizimin sistematik të të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës, në aspektin teknik, ekonomik dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare si më poshtë:

A. Të dhëna për sipërfaqen e tokës së zonës së lejuar të një lejeje minerare:

- a) Tokë bujqësore me nivelin e bonitetit;
- b) Tokë e fondit pyjor dhe kullosor;
- c) Tokë në pronësi të autoriteteve vendore;
- d) Tokë shtetërore;
- e) Tokë private;
- f) Tokë në pronësi të subjektit zotërues të lejes minerare.

B. Të dhëna për pasurinë e paluajtshme të zotëruesit të lejes minerare:

a) Punime themelore, ndihmëse dhe të shfrytëzimit, për zhvillimin e veprimtarisë minerare në nëntokë ose me karrierë.

b) Objekte sipërfaqësore, si: rrugë automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit mineral, kolona pusesh, anekse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materiale, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.

c) Tokë e zonës së lejuar të lejes minerare në pronësi të subjektit zotërues të lejes minerare.

d) Makineri e pajisje të nëntokës apo sipërfaqes që përdoren për zhvillimin e veprimtarisë minerare.

e) Impiante përpunimi të mineralit.

f) Impiante të riciklimit të mbetjeve dhe ujërave.

g) Pajisje për monitorimin e veprimtarisë minerare dhe rrezikut mineral.

h) Dambat apo strukturat e ndërtuara për depozitimin e mbetjeve.

i) Vlerën financiare të pasurive të paluajtshme të vlerësuara në momentin e regjistrimit.

C. Të dhëna për pasurinë e paluajtshme ekzistuese në zonën e lejuar të lejes minerare:

a) Punime themelore, ndihmëse, të shfrytëzimit, të realizuara në objektin mineral nga ish-ndërmarrjet minerare shtetërore ose zotërues të mëparshëm të lejes minerare për atë objekt mineral.

b) Objekte sipërfaqësore të ndërtuara në objektin mineral nga ish-ndërmarrjet minerare shtetërore ose zotërues të mëparshëm të lejes minerare për atë objekt mineral, si: rrugë automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit mineral, kolona pusesh, anekse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materiale, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.

c) Tokë e zonës së lejuar të lejes minerare në pronësi të shtetit dhe/ose autoriteteve vendore dhe/ose private dhe/ose kompensuar.

d) Makineri e pajisje të nëntokës apo sipërfaqes që përdoren për zhvillimin e veprimtarisë minerare, që kanë qenë pronësi e ish-ndërmarrjeve minerare shtetërore.

e) Impiante përpunimi të mineralit, impiante të riciklimit të mbetjeve dhe ujërave, pajisje për

monitorimin e veprimtarisë minerare dhe rrezikut mineral, damba apo struktura të ndërtuara për depozitimin e mbetjeve që kanë qenë pronësi e ish-ndërmarrjeve minerare shtetërore.

f) Vlerën financiare të pasurive të paluajtshme, të vlerësuara në momentin e regjistrimit.

D. Të dhëna për pasuritë e paluajtshme të tjera të realizuara nga zotëruesi i lejes minerare në kuadrin e veprimtarisë minerare, por jo të lidhur me këtë veprimtari që mund të jenë ose të mos jenë pronë e zotëruesit të lejes minerare:

a) Objekte social-kulturore, të edukimit, objekte për mbrojtjen e shëndetit të komunitetit të zonës minerare.

b) Objekte të infrastrukturës si rrugë etj., që i shërbejnë komunitetit të zonës minerare.

12. Të dhënat që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme të krijuara nga zotëruesi i lejes minerare që përfshihen në kadastrën minerare regjistrohen në këtë kadastrë pas kërkesës së zotëruesit të lejes minerare që vërteton pronësinë e tyre në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për pronësinë e paluajtshme.

13. Të dhënat që përfshihen në kadastrën minerare dhe kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme të krijuara nga ish-ndërmarrjet shtetërore minerare, regjistrohen në kadastrën minerare pas vlerësimeve të institucioneve minerare dhe paraqitjes së këtyre vlerësimeve në QKL, ku bëhet regjistrimi i tyre për çdo objekt mineral apo zonë minerare.

14. Të dhënat për pronësinë e tokës merren nga institucionet përkatëse të vërtetimit të kësaj pronësie dhe regjistrohen në kadastrën minerare nga QKL-ja, ku bëhet regjistrimi i tyre për çdo objekt mineral apo zonë minerare.

15. Institucioni i QKL-së mban kadastrën minerare, duke lidhur të gjitha të dhënat për një zonë minerare me të dhënat e pasurive të paluajtshme, pronësisë së tokës të kësaj zone minerare dhe realizon administrimin e këtyre të dhënave për strukturat përgjegjëse të veprimtarisë minerare në bazë të akteve ligjore të funksionimit të kësaj qendre.

16. Të dyja dokumentet e regjistrimit mineral dhe të kadastrës minerare lidhen me njëri-tjetrin nëpërmjet zonës minerare që është elementi i parë identifikues i të dy regjistrave.

17. Regjistrat regjistrohen në formë elektronike në institucionin e QKL-së. Niveli i konfidencialitetit të të dhënave realizohet në respekt të kërkesave të legjislacionit mineral dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

18. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucionet e QKL-së, QKR-së, SHGJSH-së, AKBN-së dhe drejtoria përgjegjëse në METE që trajton problematikën e lejeve minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

**URDHËR**  
**Nr.386, datë 20.5.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE MINERARE TË NJË LEJEJE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50, pika 6 dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Të gjitha të dhënat për burimet minerare në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga mënyra e ruajtjes së tyre, i përkasin shtetit shqiptar dhe i vihen në dispozicion strukturës përgjegjëse, me kërkesë të kësaj të fundit, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”.

2. Të dhënat teknike dhe provat studimore, që zotërohen nga strukturat përgjegjëse si rezultat i punës së këtyre strukturave, të cilat i përkasin shtetit shqiptar disponohen dhe përdoren në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3. Të dhënat teknike dhe provat studimore që zotërohen nga strukturat përgjegjëse të përfutuara nga informacionet e detyrueshme të zotëruesve të lejeve minerare janë konfidenciale.

4. Të dhënat teknike dhe provat studimore që zotëruesi i lejes minerare i krijon gjatë realizimit të veprimtarisë së tij minerare dhe janë pjesë e informacioneve të detyrueshme që zotëruesi i lejes minerare realizon te strukturat përgjegjëse janë konfidenciale. Zotëruesi i lejes minerare mund të shfrytëzojë të dhënat e

sipërpërmendura vetëm në interes të atij vetë dhe vetëm gjatë afatit të vlefshmërisë së lejes minerare. Transferimi i këtyre të dhënave nga zotëruesi apo ish-zotëruesi i lejes drejt palëve të treta mund të bëhet vetëm pas miratimit paraprak nga struktura përgjegjëse dhe duke respektuar legjislacionin shqiptar për të drejtat e autorit.

5. Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nuk quhen konfidenciale. Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare publikohen në kuadër të transparencës me publikun për veprimtaritë minerare.

6. Çdo aplikues për një të drejtë minerare mund të përdorë të dhënat e marra nga strukturat përgjegjëse apo zotërues të mëparshëm të lejeve minerare, duke ruajtur konfidencialitetin e tyre dhe duke deklaruar burimin e tyre në momentin e aplikimit.

7. Përdorimi i të dhënave teknike dhe provat studimore, që zotëruesi i lejes minerare i krijon gjatë realizimit të veprimtarisë së tij minerare dhe që janë konfidenciale mund të përdoren kur zotëruesi i këtyre të dhënave është dakord që të ndiqet radha, si më poshtë:

- a) përfundimi i afatit të së drejtës minerare;
- b) zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit kryen aplikim për leje minerare shfrytëzimi;
- c) lënia e zonës, në të cilën janë marrë të dhënat teknike, dhe provat studimore;
- d) dy vjet më pas nga data e marrjes së këtyre të dhënave dhe provave prej strukturës përgjegjëse;
- e) publikimi i të dhënave të tilla.

Nuk mund të kryhet ekzekutimi i pikës pasardhëse para asaj paraardhëse.

8. Përcaktimet e pikës 6 nuk mund të kufizojnë të drejtën e shtetit për të përdorur një informacion të tillë për përgatitjen e raporteve ekonomiko-financiare apo dhe tekniko-shkencore që i nevojiten atij.

9. Rezultatet e provave studimore që përfshijnë analizat kimike, mineralogjike, petrografike, studimet teknologjike etj., në kuadër të raportit përfundimtar me mbylljen e afatit të lejes minerare dorëzohen pranë institucionit të SHGJSH-së për lejet e kërkim-zbulimit dhe në AKBN për lejet e shfrytëzimit. Kampionatura për rezultatet përbehet nga:

a) Për shpimet e realizuara në lejet e kërkim-zbulimit, zotëruesi i lejes dorëzon te SHGJSH-ja: grafikisht kolonat gjeologjike të shpimeve, dublikatat e mostrave të analizave kimike, ku është kapur trupi mineral, shlife dhe anshlife përfaqësuese nga studimet mineralogjike dhe petrografike, si dhe përshkrimin e tyre.

b) Për provat e trajtimit të mineralit, zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit, shfrytëzimit apo kërkim-zbulim-shfrytëzimit dorëzon grafikisht skemën teknologjike me parametrat e realizuar për çdo produkt të skemës që përfshijnë: sasinë, cilësinë, rikuperimin, përmbajtjen e të ngurtës, dublikata të analizave kimike të produktit përfundimtar dhe përshkrim të parametrave të pajisjeve të përdorura në skemën teknologjike.

10. Struktura përgjegjëse dhe autoritetet e tjera shtetërore që kryejnë funksione shtetërore në fushën minerare, janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të marra nga zotëruesit e lejeve minerare apo të të dhënave, për të cilat kanë marrë dijeni gjatë ushtrimit të funksionit të tyre e që përbëjnë sekret tregtar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

11. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucionet e SHGJSH-së, AKBN-së dhe drejtoria përgjegjëse në METE që trajton problematikën e lejeve minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

**URDHËR**  
**Nr.387, datë 20.5.2011**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË PROJEKTIT TË KONSERVIMIT TË MINIERËS**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 55, pika 8 dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Të gjitha minierat e braktisura që sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohen si të tilla, kalojnë në regjim konservimi dhe

monitorimi postminerar pas studimeve vlerësuese të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. AKBN-ja i propozon ministrit zonat e lejeve minerare për konservim, në bazë të një projekti konservimi. Ky projekt konservimi hartohet për objektet minerare në rastet kur:

a) minierat e shfrytëzuara nga shteti kanë akoma rezerva gjeologjike dhe procesi i shfrytëzimit mund të vazhdojë nga subjekte të interesuara;

b) vazhdimi i shfrytëzimit bëhet i papërshtatshëm për motive ekonomike;

c) zotëruesi i lejes minerare braktis veprimtarinë minerare për arsye të tij, ndërkohë që aktiviteti i shfrytëzimit në këtë objekt minerar mund të ketë përfitime ekonomike;

d) për shkaqe natyrorë apo gjeologo-minerare bëhet i papërshtatshëm vazhdimi i shfrytëzimit dhe duhet të garantohet një mënyrë e re e shfrytëzimit të objektit minerar.

3. Projekti i konservimit për zonat e lejeve minerare të minierave të braktisura zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Kontrolli i zbatimit të projektit të konservimit kryhet nga AKBN-ja.

5. Procedurat e konservimit të një objekti minerar të braktisur, bëhen sipas projektit të konservimit të miratuar, në zbatim të kërkesave të nenit 55 të ligjit nr.10/304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

6. Projekti i konservimit duhet të mbështetet në parimet e:

a) mbrojtjes dhe konservimit të punimeve të realizuara në objektin minerar dhe të rezervave minerare si burime të papërsëritshme.

b) marrjes së masave parandaluese dhe mbrojtëse për jetën dhe shëndetin e komuniteteve në zonë, ndotjes në tokë, në ujërat, të florës e faunës, mjedisit dhe ekosistemit në përgjithësi, si dhe të infrastrukturës.

c) Këshillimit me autoritetet e qeverisjes vendore.

d) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

7. Projekti i konservimit të një miniere të braktisur, hartohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe miratohet nga Ministri.

8. Forma dhe përmbajtja tip e projektit të konservimit të objektit minerar do të jetë sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

#### ANEKSI 1

#### FORMA DHE PËRMBAJTJA TIP E “PLANIT TË KONSERVIMIT” PËR OBJEKTET MINERARE

##### I. PËRMBAJTJA E TEKSTIT

###### 1. Konsiderata të përgjithshme

i) Arsyetimi i realizimit të konservimit

ii) Shkaqet që influencojnë në konservimin e minierës

###### 2. Të dhëna mbi objektin minerar

A. Kur objekti minerar është braktisur nga zotëruesi i lejes minerare:

i) Zona minerare me numër identifikues nr....., e përfshirë në planin vjetor minerar të miratuar për vitin ..... dhe licencuar me lejen minerare nr....., datë...../...../.....

ii) Emri i subjektit zotërues i lejes minerare sipas regjistrimit në QKR: .....

iii) Lloji i mineralit/mineraleve: .....

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....

vi) Nr. i telefonit/faksit: .....

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njërive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....

B. Kur objekti minerar është një minierë e braktisur dhe e shfrytëzuar nga ish-ndërmarrjet shtetërore:

i) Zona minerare me numër identifikues nr.....

ii) Emri i subjektit shtetëror që është pronar i aseteve të objektit minerar .....

iii) Lloji i mineralit/mineraleve: .....

- iv) Nr. i telefonit/faksit të subjektit shtetëror: .....
- v) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....
- 3. Baza ligjore mbi të cilën hartohet projekti, si:
  - a) Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton kalimin në regjim konservimi mineral.
- 4. Të dhëna të përgjithshme të shkurtra për objektin mineral (sipas projektit të shfrytëzimit)
  - a) Vendndodhja administrative dhe topografike e objektit;
  - b) Gjeografia e zonës, relievi, bimësia, fauna, ekosistemi në përgjithësi etj.;
  - c) Ndërtimi gjeologjik i rajonit dhe vendburimit;
  - d) Lloji dhe trashësia e mbulesës së tokës në zonën minerare;
  - e) Tektonika e vendburimit;
  - f) Kushtet hidrografike dhe hidrogjeologjike të vendburimit. Llojet e ujërave dhe kimizimi i tyre;
  - g) Mbi morfologjinë dhe përbërjen e xeherorit dhe/ose xeherorëve të dobishëm. Të dhëna të shkurtra mbi llojin e mineralit, vetitë fiziko-kimike të tij.
- A. Për rastin e shfrytëzimit nëntokësor të vendburimit
  - a) Përshkrimi i mënyrës së hapjes së minierës, punimet kryesore të hapjes, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedhin nga punimet minerare, sasia dhe përbërja mineralogjike e sterileve, vendndodhja e shesheve të depozitimit, impianteve të përpunimit dhe riciklimit;
  - b) Sistemi i shfrytëzimit të përdorur dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar, sasia dhe cilësia e rezervave të shfrytëzuara ose që mund të shfrytëzohen, të ndara sipas horizonteve dhe profileve;
  - c) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore, si: rrugë, puse, zyra, dushe e tualete, gardëroba, fjetore, mensë, magazinë materialesh, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.
- B. Për rastin e shfrytëzimit me karrierë të vendburimit
  - a) Përshkrimi i varianteve të hapjes së rrugëve dhe gjysmëtrasheve, gjatësia dhe seksioni i tyre. Përcaktimi i kufijve faktikë të karrierës, dimensionet reale të saj, përcaktimi i koordinatave të vertekseve, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedhin në karrierë dhe që dalin prej saj, vendndodhja e shesheve të depozitimit të mbetjeve, vendndodhja e impianteve të përpunimit dhe riciklimit;
  - b) Sistemi i shfrytëzimit që është përdorur dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar, sasia dhe cilësia e rezervave të shfrytëzuara ose që mund të shfrytëzohen të ndara sipas horizonteve dhe profileve;
  - c) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore, si: rrugë, puse, zyra, dushe e tualete, gardëroba, fjetore, mensë, magazinë materialesh, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.
- 5. Inventari i investimeve të kryera në objektin mineral
  - a) Inventari fizik faktik i miratuar;
  - b) Inventari i punimeve themelore, përgatitore dhe të shfrytëzimit;
  - c) Inventari kontabël (i miratuar nga bilanci kontabël);
  - d) Lista e makinerive e pajisjeve teknologjike.
- 6. Parashikimi i mënyrës dhe operacioneve të konservimit të minierës:
 

Për rastin e objekteve minerare, ku është përdorur shfrytëzimi nëntokësor:

  - a) Mbylljen e grykave të punimeve të hapjes së minierës me porta;
  - b) Rrethimi i zonës administrative dhe industriale dhe zonave të rrezikshme;
  - c) Vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndaluese;
  - d) Përcaktimi i vendrojave dhe personelit përkatës;
  - e) Përcaktimi i planit dhe grafikut të kontrollit dhe shërbimit të pajisjeve e makinerive në nëntokë dhe sipërfaqe;
  - f) Përcaktimi i planit dhe grafikut të kontrollit dhe shërbimit të godinave industriale dhe ambienteve të shërbimit social-kulturore;
  - g) Përcaktimi i planit dhe i grafikut të provës së gatishmërisë teknike të makinerive e pajisjeve;
  - h) Përcaktimi i numrit të nevojshëm të punonjësve të ruajtjes dhe shërbimit për periudhën e konservimit.

Për rastin e objekteve minerare ku është përdorur shfrytëzimi me karrierë:

  - a) Mbyllja dhe/ose bllokimi i rrugëve, trasheve ose gjysmëtrasheve të hyrjes në karrierë;
  - b) Rrethimi i hapësirës dhe/ose hapësirave të krijuara nga shfrytëzimi me karrierë;

- c) Vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndaluese;
  - d) Përcaktimi i vendrojave dhe personelit përkatës;
  - e) Përcaktimi i planit dhe i grafikut të kontrollit dhe shërbimit të pajisjeve e makinerive në sipërfaqe;
  - f) Përcaktimi i planit dhe i grafikut të kontrollit dhe shërbimit të godinave industriale dhe ambienteve të shërbimit social-kulturor;
  - g) Përcaktimi i planit dhe i grafikut të provës së gatishmërisë teknike të makinerive e pajisjeve;
  - h) Përcaktimi i numrit të nevojshëm të punonjësve të ruajtjes dhe shërbimit për periudhën e konservimit.
7. Preventivi i detajuar dhe i specifikuar për çdo operacion për konservimin e objektit mineral.
8. Përfundime dhe rekomandime.

## II. PJESA GRAFIKE

| Nr. | Emërtimi                                                                                                                                                   | Shkalla                                  |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|
| A   | Për minierat nëntokësore                                                                                                                                   |                                          |
| 1   | Harta topografike e zonës së objektit mineral me koordinatat                                                                                               | 1:25000                                  |
| 2   | Planimetria e përgjithshme me punimet e hapjes (të azhurnuara me gjendjen përfundimtare)                                                                   | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000 ose 1:500  |
| 3   | Planimetria e vendosjes së objekteve administrative, social-kulturore dhe industriale (e azhurnuar me gjendjen përfundimtare)                              | 1:500 ose 1:200                          |
| 4   | Planimetria, gentplani dhe skema e vendosjes së makinerive e pajisjeve në nëntokë dhe sipërfaqe                                                            | 1:500 ose 1:200                          |
| 5   | Pasaportat e mbylljes së punimeve kryesore në minierë                                                                                                      | 1:500 ose 1:200                          |
| 6   | Skema e rrethimit dhe vendosjes së sinjalistikës parandaluese                                                                                              | 1:500 ose 1:200                          |
| B   | Për karrierat                                                                                                                                              |                                          |
| 1   | Harta topografike e zonës së objektit mineral me koordinatat                                                                                               | 1:25000                                  |
| 2   | Planimetria e përgjithshme e karrierës në fund të shfrytëzimit, e azhurnuar me gjendjen përfundimtare                                                      | 1:1000 ose 1:2000 ose 1:500              |
| 3   | Harta gjeologo-topografike e objektit me rrugët e hapjes dhe sheshet e depozitimit të sterileve apo nënprodukteve, me gjendjen përfundimtare               | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 4   | Planimetria e vendosjes së objekteve administrative, social-kulturore dhe industriale dhe skema e vendosjes së makinerive dhe pajisjeve në sheshin e punës | 1:100, 1:200 ose skematike me parametra  |
| 5   | Pasaportat e mbylljes së rrugëve hyrëse në karrierë                                                                                                        | 1:500 ose 1:200                          |
| 6   | Skema e rrethimit të hapësirës së karrierës dhe vendosjes së sinjalistikës parandaluese                                                                    | 1:500 ose 1:200                          |

## URDHËR

Nr.388, datë 20.5.2011

### PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES TË PLANIT TË MONITORIMIT POSTMINERAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 54, pika 6 dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”,

## URDHËROJ:

1. Plani i monitorimit postminerar është pjesë e planit të rehabilitimit të zonës minerare, si kapitull i veçantë i tij. Plani i monitorimit postminerar përgatitet nga aplikuesi për marrjen e një lejeje minerare dhe hartohet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar në fushën e veprimtarive studimore projektuese në fushën minerare. Ky plan hartohet në përputhje me parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të veprimtarisë minerare, që mbështeten në legjislacionin mineral dhe mjedisor në fuqi.

2. Plani i monitorimit postminerar i një miniere të braktisur, të shfrytëzuar nga ish- ndërmarrjet shtetërore, apo një objekti mineral kërkim-zbulimi me puse shpimi, të realizuar nga shteti, hartohet nga strukturat përgjegjëse, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për zonat e kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

3. Plani i monitorimit postminerar për zonat e lejeve minerare dhe minierave të braktisura të shfrytëzuara nga shteti zbatohet nga subjekte të specializuara shtetërore: SHGJSH-ja për lejet e kërkim-zbulimit dhe AKBN-ja për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit, ose private, të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi nga struktura përgjegjëse dhe

monitorohet nga ajo.

4. Kontrolli i zbatimit të planit të monitorimit postminerar kryhet nga SHGJSH-ja për lejet e kërkim-zbulimit dhe AKBN-ja për lejet e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

5. Procedurat e monitorimit postminerar të një objekti minerar, që është mbyllur ose që ka përfunduar veprimtarinë minerare, realizohen sipas planit të monitorimit postminerar të miratuar, në zbatim të kërkesave të nenit 54 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

6. Plani i monitorimit postminerar duhet të mbështetet në parimet e:

a) Monitorimit të vazhdueshëm të ndotjes në tokë, në ujëra, te flora e fauna dhe në ekosistemin në përgjithësi, si dhe të respektimit të standardeve minimale, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

b) Përcaktimit të saktë të pikave të monitorimit për emetimet dhe shkarkimet e elementeve të dëmshme në mjedis gjatë operimit dhe në të ardhmen.

c) Vendosies së pajisjeve monitoruese sipas karakteristikave të shkarkimeve, përbërjes, dekompozimit në kohë sipas teknologjive të reja dhe praktikave më të mira.

d) Përcaktimit të pikave monitoruese që do t'i shërbejnë informacionit për përcaktimin e marrjen e masave paraprake parandaluese.

e) Garantimit të monitorimit të efekteve të mbetjeve për të ardhmen për një periudhë sa më të gjatë.

f) Këshillimit me autoritetet e qeverisjes vendore.

g) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

7. Plani i monitorimit postminerar përditësohet sipas afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni mjedisor në fuqi dhe duhet të përmbajë:

a) Projektin e monitorimit postminerar që duhet të realizohet duke pasur parasysh:

i) përshkrim të përgjithshëm të territorit, florës dhe faunës;

ii) sheshin e depozitimit të mbetjeve;

iii) përbërjen e mbetjeve minerare dhe karakteristikat fiziko-kimike të tyre;

iv) lëvizjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore;

v) afërsinë me infrastrukturën dhe zonat e banuara;

vi) ndikimin në ekosistemin e zonës minerare dhe asaj përreth saj;

vii) ndikimin në ekosistemin në përgjithësi;

viii) nivelin e shkarkimeve në mjedis dhe ndotjen që shkakton tek ujërat sipërfaqësore e nëntokësore të florës e të faunës.

b) Parashikimin për vendet dhe kohën për monitorimin e shkarkimeve pas procesit të mbylljes së minierës, karrierës, impianteve të riciklimit dhe sheshit të depozitimit.

c) Procedurat dhe afatet kohore të realizimit të punimeve për vendosjen e pikave monitoruese;

d) Procedurat e monitorimit për raste të emergjencës për ndotjet aksidentale.

e) Për veprimtaritë minerare, mbetjet e të cilave rezultojnë nga procese ku përdoren lëndë toksike dhe të rrezikshme, si: cianure, acide, substanca kimike të rrezikshme, plani i monitorimit postminerar duhet, gjithashtu, të përfshijë:

i) monitorimin e nivelit të koncentrimit të elementeve toksike ose të rrezikshme në depozitimet e mbetjeve minerare apo shkarkimet prej tyre, në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin;

ii) mënyrën e monitorimit të vazhdueshëm sipas afateve kohore në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin.

8. Dokumentet informative që mbahen nga strukturat përgjegjëse apo subjektet e përzgjedhura për realizimin e monitorimit postminerar, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar dhe atij mjedisor në fuqi dhe duhet të përmbajnë, gjithashtu:

a) Gentplanin e pikave të monitorimit për zonën e lejuar minerare dhe të sheshit të depozitimit të sterileve, sipas projektit të miratuar.

b) Gentplanin e pikave të monitorimit për impiantin e riciklimit.

c) Pasqyrat për monitorimet sipas afateve kohore të përcaktuara në lidhje me përbërjen fizike dhe kimike të shkarkimeve në mjedis për të gjitha pikat e monitorimit, e shoqëruar me fletë-analizat përkatëse.

9. Forma dhe përmbajtja tip e “planit të monitorimit postminerar” për lejet e kërkim-zbulimit do të jetë sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

10. Forma dhe përmbajtja tip e “planit të monitorimit postminerar” për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit do të jetë sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

11. Sipas shkallës së rrezikshmërisë aktuale të vrojtuar dhe përcaktuar në terren dhe asaj të pritshme për shkak të ndryshimit në kohë të parametrave të ndryshëm që lidhen me të, zonat e rrezikshme mund të klasifikohen sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij urdhri.

12. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucionet e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).  
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

ANEKSI 1  
FORMA DHE PËRMBAJTJA TIP E “PLANIT TË MONITORIMIT POSTMINERAR” PËR LEJET E  
KËRKIM-ZBULIMIT

I. PËRMBAJTJA E TEKSTIT

1. Konsiderata të përgjithshme
2. Të dhëna mbi subjektin kur plani hartohet për një zonë të re minerare:
  - i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
  - ii) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën kërkohet leja minerare dhe që përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin .....
  - iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënia e lejes: .....
  - iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR: .....
  - v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
  - vi) Nr. i telefonit/faksit: .....
  - vii) Emërtimi i njësive vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....
  - viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: .....
  - ix) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: ...../...../.....
3. Baza ligjore mbi të cilën hartohet projekti, si:
  - a) Urdhrit të Ministrit për planin vjetor minerar;
  - b) Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton kalimin në regjim monitorimi postminerar, për rastin kur kjo minierë është shfrytëzuar nga shteti.
4. Të dhëna të përgjithshme të shkurtra për objektin minerar (sipas projektit të shfrytëzimit)
  - a) Vendndodhja administrative dhe topografike e objektit;
  - b) Gjeografia e zonës, relievi, bimësia, fauna, ekosistemi në përgjithësi etj.
  - c) Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike të vendburimit. Llojet e ujërave dhe kimizimi i tyre;
  - d) Mbi morfologjinë dhe përbërjen e xeherorit dhe/ose xeherorëve të dobishëm. Të dhëna të shkurtra mbi llojin e mineralit, vetitë fiziko-kimike të tij.
- a) Përshkrimi i mënyrës së realizimit të veprimtarisë së kërkim-zbulimit, punimet kryesore të kërkim-zbulimit, trashe, galeri, puse, sasia dhe përbërja mineralogjike e sterileve, vendndodhja e shesheve të depozitimit.
  - b) Dokumentimi i pasojave në infrastrukturë dhe ndërtime, që lidhen me çarje ose shembjen e tokës.
  - c) Pasoja në mjedis që lidhen me ndotjen e ujërave dhe nivelin e ndotjes kimike, si rezultat i shkarkimeve, gjatë punëve të kërkim-zbulimit dhe depozitimit të mbetjeve.
5. Monitorimi i ujërave të ndryshme që rrjedhin në sipërfaqe dhe sheshet e depozitimit të mbetjeve.
  - a) Përcaktimi i stacioneve të matjeve monitoruese dhe dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës së zbuluar.
  - b) Përcaktimi i llojit të numrit dhe periodave të matjeve me të cilat do të bëhet monitorimi.
  - c) Zgjedhja e pajisjeve matëse dhe serive të matjeve. Dokumentimi i rezultateve të matjeve në regjistrin përkatës.
  - d) Përcaktimi i masave parandaluese, paralajmëruese dhe parashikimi i efekteve negative në infrastrukturë, qendrat e banuara apo ambientet e tjera industriale e social-kulturore. Përcaktimi i kritereve të alarmit.
  - e) Për veprimtaritë minerare të kërkim-zbulimit kur përdoren lëndë të rrezikshme, duhet, gjithashtu, të përcaktohen:
    - i) monitorimi i nivelit të koncentrimit të elementeve toksike ose të rrezikshme në shkarkimet në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin;
    - ii) mënyra e monitorimit të vazhdueshëm sipas afateve kohore në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin.
6. Hartimi i preventivit përmbledhës të shpenzimeve.



## II. PJESA GRAFIKE

|   |                                                                                                                                                                              |                |
|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| 1 | Harta topografike e sipërfaqes me burimet e rrjedhjes së ujërave, stoqet e mbetjeve. Planimetria e sistemit të sterileve dhe e stacioneve të ndryshme të marrjes së mostrave | 1:1000, 1:2000 |
| 2 | Prerje dhe projeksione të ndryshme shoqëruese                                                                                                                                | 1:1000, 1:2000 |
| 3 | Planimetri e përdorimit të tokës                                                                                                                                             | 1:1000, 1:2000 |

### ANEKSI 2

#### FORMA DHE PËRMBAJTJA TIP E “PLANIT TË MONITORIMIT POSTMINERAR” PËR LEJET E SHFRYTËZIMIT DHE LEJET E KËRKIM-ZBULIM-SHFRYTËZIMIT

##### I. PËRMBAJTJA E TEKSTIT

1. Konsiderata të përgjithshme
2. Të dhëna mbi subjektin kur plani hartohet për një zonë të re minerare:
  - i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
  - ii) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën kërkohet leja minerare dhe që përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin .....
  - iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënia e lejes: .....
  - iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR: .....
  - v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR: .....
  - vi) Nr. i telefonit/faksit: .....
  - vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar: .....
  - viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: .....
  - ix) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: ...../...../.....
3. Baza ligjore mbi të cilën hartohet projekti, si:
  - a) Urdhrin e Ministrit për planin vjetor minerar.
  - b) Vendimin e Këshillit të Ministrave që miraton kalimin në regjim monitorimi postminerar, për rastin kur kjo minierë është shfrytëzuar nga shteti.
4. Të dhëna të përgjithshme të shkurtra për objektin minerar (sipas projektit të shfrytëzimit)
  - a) Vendndodhja administrative dhe topografike e objektit;
  - b) Gjeografia e zonës, relievi, bimësia, fauna, ekosistemi në përgjithësi etj.;
  - c) Ndërtimi gjeologjik i rajonit dhe vendburimit;
  - d) Lloji dhe trashësia e mbulesës së tokës në zonën minerare;
  - e) Tektonika e vendburimit;
  - f) Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike të vendburimit. Llojet e ujërave dhe kimizimi i tyre;
  - g) Mbi morfologjinë dhe përbërjen e xeherorit dhe/ose xeherorëve të dobishëm. Të dhëna të shkurtra mbi llojin e mineralit, vetitë fiziko-kimike të tij.
- A. Për rastin e shfrytëzimit nëntokësor të vendburimit
  - a) Përshkrimi i mënyrës së hapjes së minierës, punimet kryesore të hapjes, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedhin nga punimet minerare, sasia dhe përbërja mineralogjike e sterileve, vendndodhja e shesheve të depozitimit, vendndodhja e impianteve të riciklimit;
  - b) Sistemi i shfrytëzimit të përdorur dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar, sasia dhe cilësia e rezervave të shfrytëzuara ose që mendohen të shfrytëzohen të ndara sipas horizonteve dhe profileve;
  - c) Përcaktimi i zonave të rrezikshme që lidhen me qëndrueshmërinë e shkëmbinjve:
    - i) Zona të rrezikshme të shkallës së parë;
    - ii) Zona të rrezikshme të shkallës së dytë;
    - iii) Zona të rrezikshme të shkallës së tretë.
  - d) Dokumentimi i pasojave në infrastrukturë dhe ndërtime, që lidhen me çarje ose shembjen e tokës nga influenca e shfrytëzimit dhe punimeve minerare.
  - e) Pasoja në mjedis që lidhen me ndotjen e ujërave dhe nivelin e ndotjes kimike si rezultat i shkarkimeve, përpunimit, riciklimit dhe depozitimit të mbetjeve;
  - f) Sasia dhe lloji i pluhurave dhe gazeve që emetohen nga miniera apo impiantet e përpunimit dhe riciklimit;
  - g) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore apo që mendohen të realizohen si rrugët automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit, sisteme për sheshet e ndërtimit të objekteve sipërfaqësore, puse anekse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materiale, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.

B. Për rastin e shfrytëzimit me karrierë të vendburimit

a) Përshkrimi i varianteve të hapjes së rrugëve dhe gjysmëtransheve, gjatësia dhe seksioni i tyre. Përcaktimi i kufijve faktikë të karrierës, dimensionet reale të saj, përcaktimi i koordinatave të vertekseve, sasia dhe lloji i ujërave që rrjedhin në karrierë dhe që dalin prej saj, sasia dhe përbërja mineralogjike e sterileve, vendndodhja e shesheve të depozitimit, vendndodhja e impianteve të riciklimit;

b) Sistemi i shfrytëzimit që do të përdoret ose është përdorur dhe treguesit tekniko-ekonomikë të realizuar, sasia dhe cilësia e rezervave që mendohen të shfrytëzohen ose të shfrytëzuara të ndara sipas horizonteve dhe profileve;

c) Përcaktimi i zonave të rrezikshme që lidhen me qëndrueshmërinë e shkëmbinjve:

i) Zona të rrezikshme të shkallës së parë;

ii) Zona të rrezikshme të shkallës së dytë;

iii) Zona të rrezikshme të e shkallës së tretë.

d) Dokumentimi i pasojave në infrastrukturë dhe ndërtime, që lidhen me çarje ose shembjen e tokës nga influenca e shfrytëzimit dhe punimeve minerare;

e) Pasoja në mjedis që lidhen me ndotjen e ujërave dhe nivelin e ndotjes kimike si rezultat i shkarkimeve, përpunimit, riciklimit dhe depozitimit të mbetjeve;

f) Sasia dhe lloji i pluhurave dhe gazeve që emetohen nga karriera apo impiantet e përpunimit dhe riciklimit;

g) Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore apo që mendohen të realizohen si rrugët automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit, sistemime për sheshet e ndërtimit të objekteve sipërfaqësore, puse anekse, zyra, dushe e tualete, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materialesh, sallë kompresorësh, kabina elektrike, stacion pompimi, ofiçina, depo e lëndës plasëse dhe ambiente të tjera.

5. Monitorimi i riskut të shembjes në minierat e mbyllura

a) Përcaktimi i zonave potenciale me risk për shembje dhe dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës së shfrytëzuar. Piketimi në terren;

b) Përcaktimi i zonës me shembje dhe me risk zmadhimin e tyre në perspektivë dhe dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës së shfrytëzuar. Piketimi në terren;

c) Teknikat e ndryshme të monitorimit që parashikohen të përdoren;

d) Përcaktimi i stacioneve të matjeve monitoruese dhe dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës së shfrytëzuar;

e) Përcaktimi i llojit të numrit dhe periodave të matjeve, me të cilat do të bëhet monitorimi. Zgjedhja e pajisjeve matëse dhe serive të matjeve;

f) Dokumentimi i rezultateve të matjeve në regjistrin përkatës;

g) Përcaktimi i masave parandaluese, paralajmëruese dhe parashikimi i efekteve negative në infrastrukturë, qendrat e banuara apo ambientet e tjera industriale e social-kulturore. Përcaktimi i kritereve të alarmit;

h) Përcaktimi i sinjalistikës ndaluese dhe paralajmëruese për zonat me shembje dhe/ose potenciale me risk shembjeje;

i) Informimi periodik i strukturave përgjegjëse dhe pushtetit lokal mbi rezultatet e monitorimit;

j) Përcaktimi i shpenzimeve të monitorimit dhe hartimi i preventivit të përgjithshëm të shpenzimeve;

k) Parashikimin e ndikimit të florës dhe faunës dhe në ekosistemin në përgjithësi.

6. Monitorimi i ujërave të ndryshme që rrjedhin në sipërfaqen e minierës ose karrierës, stoqet dhe sheshet e depozitimit të mbetjeve, impiantet e përpunimit dhe riciklimit, ose dalin prej saj,

a) Përcaktimi i pikave të ndryshme të rrjedhjes së ujërave dhe burimit të tyre. Dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës minerare. Piketimi në terren;

b) Teknikat e ndryshme të monitorimit që parashikohen të përdoren;

c) Përcaktimi i stacioneve të matjeve monitoruese dhe dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës së shfrytëzuar;

d) Përcaktimi i llojit të numrit dhe periodave të matjeve, me të cilat do të bëhet monitorimi;

e) Zgjedhja e pajisjeve matëse dhe serive të matjeve;

f) Dokumentimi i rezultateve të matjeve në regjistrin përkatës;

g) Përcaktimi i masave parandaluese, paralajmëruese dhe parashikimi i efekteve negative në infrastrukturë, qendrat e banuara apo ambientet e tjera industriale e social kulturore. Përcaktimi i kritereve të alarmit;

h) Përcaktimi i sinjalistikës ndaluese dhe paralajmëruese për zonat me ujëra të ndotura dhe/ose potenciale me risk ndotjeje;

i) Informimi periodik i strukturave përgjegjëse dhe pushtetit lokal mbi rezultatet e monitorimit;

- j) Përcaktimi i shpenzimeve të monitorimit dhe hartimi i preventivit të përgjithshëm të shpenzimeve;
- k) Përcaktimi i llojit të numrit dhe periodave të matjeve, me të cilat do të bëhet monitorimi për rastet e ngjarjeve aksidentale;
- l) Parashikimin e ndikimit të florës dhe faunës dhe në ekosistemin në përgjithësi;
- m) Parashikimin për nivelin e shkarkimeve në mjedis dhe ndotjen që shkakton tek ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, të florës e të faunës;
- n) Procedurat e monitorimit për raste të emergjencës për ndotjet aksidentale;
- o) Për veprimtaritë minerare ku përdoren lëndë toksike dhe të rrezikshme, si: cianure, acide, substanca kimike të rrezikshme, duhet, gjithashtu, të përcaktohen:
- i) Monitorimi i nivelit të koncentrimit të elementeve toksike ose të rrezikshme në depozitimet e mbetjeve minerare, apo shkarkimet prej tyre, në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin;
- ii) Mënyrën e monitorimit të vazhdueshëm, sipas afateve kohore në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin.
7. Monitorimi i gazrave pluhurave të ndryshme, që dalin nga objekti minerar dhe objektet e përpunimit dhe riciklimit;
- a) Përcaktimi i pikave të ndryshme të emetimit të gazeve nga miniera dhe burimet e tyre. Dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës minerare. Piketimi në terren;
- b) Teknikat e ndryshme të monitorimit, që parashikohen të përdoren;
- c) Përcaktimi i stacioneve të matjeve monitoruese dhe dokumentimi i tyre në hartën topografike të sipërfaqes së zonës së shfrytëzuar;
- d) Përcaktimi i llojit të numrit dhe periodave të matjeve, me të cilat do të bëhet monitorimi.
- e) Zgjedhja e pajisjeve matëse dhe serive të matjeve;
- f) Dokumentimi i rezultateve të matjeve në regjistrin përkatës;
- g) Përcaktimi i masave parandaluese, paralajmëruese dhe parashikimi i efekteve negative në infrastrukturë, qendrat e banuara apo ambientet e tjera industriale e social-kulturore. Përcaktimi i kritereve të alarmit;
- h) Përcaktimi i sinjalistikës ndaluese dhe paralajmëruese për zonat me gaze të ndotura dhe/ose potenciale me risk ndotjeje;
- i) Informimi periodik strukturave përgjegjëse dhe pushtetit lokal mbi rezultatet e monitorimit;
- j) Përcaktimi i shpenzimeve të monitorimit dhe hartimi i preventivit të përgjithshëm të shpenzimeve;
- k) Përcaktimi i llojit të numrit dhe periodave të matjeve me të cilat do të bëhet monitorimi për rastet e ngjarjeve aksidentale;
- l) Parashikimin e ndikimit të florës dhe faunës dhe në ekosistemin në përgjithësi;
- m) Procedurat e monitorimit për raste të emergjencës dhe aksidentale;
- n) Për veprimtaritë minerare ku përdoren lëndë toksike dhe të rrezikshme, si: cianure, acide, substanca kimike të rrezikshme, duhet, gjithashtu, të përcaktohen:
- i) Monitorimi i nivelit të koncentrimit të elementeve toksike ose të rrezikshme në ajër, në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin;
- ii) Mënyra e monitorimit të vazhdueshëm sipas afateve kohore në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin.
8. Teknologjitë e riciklimit dhe përdorimi i tokës:
- a) Planifikimin e përdorimit të sipërfaqes së tokës dhe trajtimin e mbetjeve të ndryshme sterile;
- b) Projektin e trajtimit të ujërave, gazeve, tymrave dhe pluhurave;
- c) Parashikimin e masave parandaluese lidhur me gazrat e ndryshme që priten të dalin nga miniera për të eliminuar rastet aksidentale.
9. Hartimi i preventivit përmbledhës të shpenzimeve për të tri llojet e monitorimit.

## II. PJESA GRAFIKE

|   |                                                                                                                                                                                                                  |                |
|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| 1 | Harta topografike e sipërfaqes me zonat me shembje dhe/ose zonat me risk potencial shembje sipas klasave                                                                                                         | 1:1000, 1:2000 |
| 2 | Hartën topografike të sipërfaqes me planin e parandalimit të rrezikut dhe zonat sipas klasave                                                                                                                    | 1:1000, 1:2000 |
| 3 | Planimetrinë e vendosjes së stacioneve të matjes të zhvendosjes së shkëmbinjve dhe zonat me shembje                                                                                                              | 1:1000, 1:2000 |
| 4 | Harta topografike e sipërfaqes me burimet e rrjedhjes së ujërave nga nëntoka ose karriera, stoqet e sterileve dhe dambat. Planimetri i sistemit të sterileve dhe e stacioneve të ndryshme të marrjes së mostrave | 1:1000, 1:2000 |

|   |                                                                                                         |                |
|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| 5 | Planimetrinë vendosjes së stacioneve të matjes së gazeve, pluhurave dhe marrjes së kampioneve           | 1:1000, 1:2000 |
| 6 | Planimetrinë e vendosjes së objekteve të përpunimit dhe e stacioneve të ndryshme të marrjes së mostrave | 1:1000, 1:2000 |
| 7 | Planimetrinë e vendosjes së objekteve të riciklimit dhe e stacioneve të ndryshme të marrjes së mostrave | 1:1000, 1:2000 |
| 8 | Prerje dhe projeksione të ndryshme shoqëruese                                                           | 1:1000, 1:2000 |
| 9 | Planimetrinë e përdorimit të tokës                                                                      | 1:1000, 1:2000 |

### ANEKSI 3 KLASIFIKIMI I ZONAVE TË RREZIKSHME

Sipas shkallës së rrezikshmërisë aktuale të vrojtuar dhe përcaktuar në terren dhe asaj të pritshme për shkak të ndryshimit në kohë të parametrave të ndryshëm që lidhen me të, zonat e rrezikshme mund të klasifikohen:

#### 1. Zona të rrezikshme të shkallës së parë

Konsiderohen të gjitha ato zona në sipërfaqe, ku rreziku i lëvizjes ose shembjes së tokës, është vazhdimisht i pranishëm dhe ku nuk duhet të kryhet asnjë lloj ndërtimi i çfarëdo kategorie qoftë ai, si dhe të hiqen ndërtimet ekzistuese, linjat elektrike, tubacionet e ujësjellësve, spostohen rrugët automobilistike dhe elemente të tjerë të infrastrukturës.

Në këto zona përfshihen:

- Sipërfaqet përreth grykave të puseve vertikale të minierave pavarësisht nga mënyra e mbylljes së tyre.

- Sipërfaqet mbi grykat e punimeve horizontale ose të pjerrëta me një gjatësi sipas aksit të punimit derisa mbulesa mbi punim të kalojë dhjetë herë lartësinë e tij, të përcaktuar në seksionin tërthor. Megjithatë, në rastet e ndërtimeve dhe elementeve të rëndësishme të infrastrukturës, me rreziqe kolektive të përmasave të ndryshme, përcaktimi i kufijve të kësaj zone duhet të bëhet me anë të studimeve përkatëse të specializuara, të cilat duhet të marrin në konsideratë ecurinë e procesit në dinamikën e tij.

- Sipërfaqet mbi hapësirat e mbetura të shfrytëzimit ose të punimeve të vjetra, atje ku ka qenë përdorur sistemi i shfrytëzimit me hapësira të hapura dhe në bazë të llogaritjeve, që marrin në konsideratë faktorët e ndryshëm, që shkaktojnë evoluimin e procesit të shkatërrimit të shkëmbinjve, rezulton që shembja e këtyre hapësirave do të ndikojë në dëmtimin e sipërfaqes.

#### 2. Zona të rrezikshme të shkallës së dytë

Konsiderohen të gjitha ato zona në sipërfaqe, mbi fushat minerare ku efektet e ndikimit të shfrytëzimit janë më të lehta. Ka ulje dhe intensiteti i tyre është i vogël. Në këto zona, mbi bazën e studimeve të detajuara, lejohen ndërtime të kufizuara në madhësi dhe mbahen në vërejtje të vazhdueshëm ndërtimet e kryera. Në këto zona mund të ndërtohen elemente të ndryshëm të infrastrukturës, të cilët duhet të jenë nën vërejtje.

#### 3. Zona të rrezikshme të shkallës së tretë

Konsiderohen ato zona, në sipërfaqe mbi fushat minerare të mbyllura, ku megjithëse pasojat e ndikimit të shfrytëzimit janë: në përfundim, të vogla ose kanë përfunduar, duhet të vazhdojnë vërejtjet dhe matjet edhe për një periudhë të shkurtër kohe, e cila do të gjykohej nga rezultatet e tyre. Në këto zona çdo ndërtim duhet të bëhet mbi bazën e studimeve gjeologjiko-inxhinierike dhe urbanistike të plota.

### URDHËR Nr.414, datë 3.6.2011

#### PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË PLANIT TË MENAXHIMIT DHE INFORMACIONEVE QË MBAHEN NGA ZOTËRUESI I LEJES MINERARE PËR PUNIMET E KRYERA, DEPOZITIMIN, TRAJTIMIN E MBETJEVE MINERARE DHE ANALIZIMIN E TYRE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 38 pika 8 dhe nenit 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minierar në Republikën e Shqipërisë”,

#### URDHËROJ:

1. Plani i menaxhimit të mbetjeve minerare është pjesë e planit të rehabilitimit të zonës minerare, si kapitull i veçantë i tij dhe përgatitet nga aplikuesi për marrjen e një leje minerare. Ky plan hartohet në

përputhje me parimet bazë për hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare të veprimtarisë minerare që mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi.

2. Procedurat e trajtimit të mbetjeve minerare, ulja e nivelit të shkarkimeve të elementeve të dëmshëm prej tyre, riciklimi, mënyrat e depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve me përmbajtje toksike dhe të rrezikshme, bëhen në pajtim me kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

3. Plani i menaxhimit të mbetjeve minerare duhet të mbështetet në parimet e:

a) Ndotjes në nivele më të ulëta në tokë, në ujërat, te flora e fauna dhe në ekosistemin, në përgjithësi dhe në përputhje me vlerat minimale, të pranueshme sipas legjislacionit në fuqi;

b) Futjes së proceseve të riciklimit;

c) Garantimit të një vendi të sigurt depozitimi për periudha të gjata kohore;

d) Garantimit të një emetimi minimal të shkarkimeve të elementeve të dëmshëm në mjedis gjatë operimit dhe në të ardhmen;

e) Trajtimit të mbetjeve minerare sipas karakteristikave të tyre, përbërjes, dekompozimit në kohë sipas teknologjive të reja dhe praktikave më të mira;

ë) Parandalimit dhe marrjes së masave paraprake;

f) Garantimit të monitorimit të efekteve të mbetjeve;

g) Këshillimit me autoritetet e qeverisjes vendore;

h) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

4. Plani i menaxhimit të mbetjeve minerare, që përditësohet çdo 5 vjet, duhet të përmbajë:

a) Projektin teknik e ndërtimor të sheshit të depozitimit të mbetjeve që duhet të përzgjidhet duke pasur parasysh:

i) kushtet e terrenit;

ii) kushtet gjeologjike të sheshit të depozitimit dhe zonës përreth tij;

iii) stabilitetin gjeoteknik;

iv) përbërjen e mbetjeve minerare dhe karakteristikat fiziko-kimike të tyre;

v) lëvizjen e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore;

vi) afërsinë me infrastrukturën dhe zonat e banuara;

vii) ndikimin në ekosistemin e zonës minerare dhe asaj përreth saj;

viii) ndikimin në ekosistemin në përgjithësi;

ix) nivelin e shkarkimeve në mjedis dhe ndotjen që shkakton tek ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, të florës e të faunës;

x) parashikimin për realizimin e procesit të mbylljes së sheshit të depozitimit;

xi) parashikimin për monitorimin e shkarkimeve;

xii) procedurat dhe afatet kohore të realizimit të punimeve për ndërtimin e sheshit të depozitimit, mënyrës së shkarkimit të mbetjeve në të, mënyrës së largimit të ujërave.

b) Mënyrën e transportimit të mbetjeve nga objekti minerar te sheshi i depozitimit të mbetjeve.

c) Mënyrën e depozitimit të mbetjeve dhe lëvizjen e ujërave në sheshin e depozitimit.

d) Mënyrën e trajtimit të mbetjeve dhe skemat e riciklimit të tyre.

e) Impaktin gjatë operimit, personat që mbulojnë procesin e operimit dhe monitorimit, procedurat e kontrollit e të monitorimit.

f) Planin e mbylljes dhe të rehabilitimit të sheshit të depozitimit.

g) Planin e emergjencës për ndotjet aksidentale, masat parandaluese dhe ato në rast aksidentesh ku të përfshihen:

i) të gjitha masat për garantimin e jetës dhe të shëndetit të punonjësve dhe komunitetit,

ii) personat që veprojnë në rast aksidentesh,

iii) masat e sigurisë për personat që veprojnë në rast aksidentesh,

iv) listën e pajisjeve të domosdoshme për raste aksidentesh,

v) mënyrën e trajtimit të tyre.

vi) fondet e nevojshme të garantuara për raste të tilla,

vii) mënyrat e operimit të tyre, duke dhënë opsionet e mundshme,

viii) mënyrën e bashkëveprimit me organin e emergjencave civile,

ix) mënyrën e informimit të strukturave përgjegjëse dhe publikut.

x) masat paraprake për shmangien e ndotjeve në mjedis,

xi) masat për rehabilitimin e mjedisit për raste aksidentale të konsultuara me njësitë e qeverisjes vendore që përditësohet çdo 3 vjet.

h) Për veprimtaritë minerare, mbetjet e të cilave rezultojnë nga procese ku përdoren lëndë toksike dhe

të rrezikshme, si: cianure, acide, substanca kimike të rrezikshme, plani i menaxhimit të mbetjeve duhet, gjithashtu, të përfshijë:

- i) Nivelin e koncentrimit të elementeve toksike ose të rrezikshme në depozitimet e mbetjeve minerare apo shkarkimet prej tyre, në respekt të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për mjedisin;
- ii) Mënyrën e monitorimit të vazhdueshëm;
- iii) Mënyrën e eliminimit të efekteve negative të lëndëve toksike dhe të rrezikshme;
- iv) Vlerësimi i planit dhe i garancisë financiare për efektet e depozitimit të këtyre mbetjeve përditësohet çdo 3 vjet.

5. Dokumentet informative që mbahen nga zotëuesi i lejes minerare për punimet e kryera, depozitim, trajtimin e mbetjeve minerare dhe analizimin e tyre në çdo kohë të vlefshme për inspektim nga strukturat përgjegjëse do të jenë si më poshtë:

- a) Gentplani i sheshit të depozitimit të sterileve, sipas projektit të miratuar me llogaritjen e kapacitetit depozitues të tij, shoqëruar me prerjet përkatëse, i azhurnuar periodikisht çdo 3 (tre) muaj për nivelin e mbetjeve të depozituara. Procesverbalet e matjes dhe azhurnimit të stokeve të depozitimit;
- b) Gentplani i impiantit të riciklimit;
- c) Gentplani i pikave të monitorimit të mbetjeve dhe shkarkimeve;
- d) Pasqyrat ditore të përbërjes fizike dhe kimike të mbetjeve që depozitohen, të shoqëruara me fletë-analizat përkatëse;
- e) Pasqyrat ditore të përbërjes fizike dhe kimike të shkarkimeve nga sheshi i depozitimit e shoqëruar me fletë-analizat përkatëse;
- f) Përmbledhëset mujore, 3-mujore, 6-mujore dhe vjetore të sasisë dhe cilësisë së mbetjeve që depozitohen;
- g) Evidenca 3-mujore, 6-mujore dhe vjetore të sasisë dhe cilësisë së mbetjeve që trajtohen nga skemat e riciklimit dhe/ose evadohen;
- h) Bilanci fizik i lëvizjes së stokeve të materialit ose mbetjeve të depozituara.

6. Forma e informacioneve duhet të jetë:

- a) për vizatimet në format A3 dhe të përshkruajë rrugën e lëvizjes së mbetjeve, shkarkimeve dhe ujërave sipërfaqësore, nivelin e depozitimit të mbetjeve në sheshin e depozitimit.
- b) pasqyrat në formë tabelore të mbajtura në programin (*Excel*) dhe mbahen nga zotëuesi i lejes minerare.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucionet e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Reparti i Inspektim Shpëtimit të Minierave (RISHM) dhe Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Nasip Naço**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

|                                                              |                 |
|--------------------------------------------------------------|-----------------|
| <b>KODI CIVIL</b>                                            | <b>360 lekë</b> |
| <b>KODI I FAMILJES</b>                                       | <b>310 lekë</b> |
| <b>KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE</b>                     | <b>90 lekë</b>  |
| <b>KODI PENAL USHTARAK</b>                                   | <b>55 lekë</b>  |
| <b>KODI I PUNËS</b>                                          | <b>140 lekë</b> |
| <b>KANONI I ZHURISË</b>                                      | <b>40 lekë</b>  |
| <b>PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE</b>         | <b>328 lekë</b> |
| <b>PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË</b>            |                 |
| <b>PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE</b>     | <b>140 lekë</b> |
| <b>PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË</b> | <b>512 lekë</b> |

Hyri në shtyp më 27.7.2011  
Doli nga shtypi më 27.7.2011

|                           |                         |
|---------------------------|-------------------------|
| <b>Tirazhi: 1700 copë</b> | <b>Formati: 61x86/8</b> |
|---------------------------|-------------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë